

Dr. Vehbetu Zuhejli

Masat ligjore

XIII

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Masat ligjore

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Masat ligjore

Këtë temë do ta sqarojmë si në vijim:

- Definicioni;
- Dallimi në mes të masës ligjore dhe bazës ligjore;
- Llojet;
- Mendimet e dijetarëve;
- Analiza e boshtit tematik;
- Çka rezulton prej mjeteve dhe masave ligjore.¹

Definicioni i mjeteve dhe masave ligjore

Gjuhësisht “**Dheria**” nënkupton mjetin me të cilën arrihet deri te një çështje.

Te dijetarët e usulit:² Mjet me të cilën realizohet një çështje e ndaluar e cila sjell dëm. Vetëm se ky definicion është i specifikuar vetëm për paraligjet e ndaluara.

Më i përshtatshmi është definicioni i Ibni Kajimit:³ “**Çdo mjet apo rrugë e cila të shpie te diçka.**”

Pjesëza “**te diçka**” nuk e ka për qëllim në përgjithësi, por kuptohet në kontekstin e fjalës kur flitet për ligjet e sheriatit: adhurimet dhe mëkatet.

Për këtë arsye e kam zgjedhur shprehjen “**mjetet ligjore**” sepse në fushën e ligjeve të sheriatit kemi dy anë, që do të thotë:

- **mjetet ligjore parandaluese**, që do të thotë *vendosjen e pengesës* për të mos arritur deri te dëmtimi nëse përfundimi i asaj çështjeje shpie në dëmtim sepse dëmtimi është i ndaluar, dhe

- **mjetet ligjore çliruese**, që do të thotë *shfrytëzimin e mjeteve të cilat sjellin dobi*, sepse dobia kërkohet.

Karafi u thotë:⁴ “Duhet të dihet se nëse në njërin anë mjetet dhe masat ligjore duhet penguar, në anën tjetër duhet çliruar sepse mjetet ligjore ose urrehen, ose pëlqehen ose lejohen.”

Mjeti ligjor është mjet ligjor dhe sikurse një mjet ligjor i dëmshëm është haram ,në anën tjetër një mjetet tjetër ligjor i domosdoshëm është obligativ (vaxhib), si f.v., angazhimi për namazin e xhumasë dhe të haxhit.

Burimet e ligjit janë dy llojesh:

1. **Qëllime** janë ato burime që pikësynojnë në vetvete dobinë dhe dëmin, dhe,

2. **Mjete** janë rrugët të cilat shpijnë te dëmi apo te dobia.

Ndërsa **dispozita** varet varësisht se a shpihet te dëmi apo te dobia, vetëm se *shkalla minimale e qëllimeve të ligjit* është mjeti i cili shpie te qëllimi më i mirë dhe te **rezultatet më të mira**, pastaj ajo çka shpie në **mesataren** deri te ato të cilat shpijnë te **mjetet më të mira**. Zoti i Lartmadhëruar thotë se:

مَا كَانَ لِأَهْلِ الْمَدِينَةِ وَمَنْ حَوْلَهُمْ مِنَ الْأَعْرَابِ أَنْ يَتَخَلَّفُوا عَنْ رَسُولِ اللَّهِ وَلَا يَرْغَبُوا بِأَنْفُسِهِمْ عَنْ نَفْسِهِ ۚ ذَٰلِكُمْ بِأَنَّهُمْ لَا يُصِيبُهُمْ ظَمَأٌ وَلَا نَصَبٌ

وَلَا مَحْمَصَةٌ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا يَطِئُونَ مَوْطِئًا يَغِيظُ الْكُفَّارَ وَلَا يَنَالُونَ مِنْ
 عَدُوِّ نِيْلًا إِلَّا كُتِبَ لَهُمْ بِهِ عَمَلٌ صَالِحٌ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ
 الْمُحْسِنِينَ

“Nuk ishte me vend për banorët e Medinës e as për ata që ishin rreth tyre nga beduinët, të ngelin (pa shkuar) pas të dërguarit të All-llahut e as të kursejnë veten e tyre ndaj vetes së tij (Pejgamberit). Nuk ishte me vend ngase, ata nuk i godet as mortja, as lodhja, as uria kur janë në rrugën e All-llahut, dhe nuk shkelin ndonjë vend që i hidhëron mosbesimtarët, dhe nuk arrijnë kundër armikut çka do qoftë (mbytje, robërim të tyre ose ngadhënjim mbi ta), vetëm se të gjitha ato do t’u evidentohen atyre si vepër e mirë (shpërblyese). All-llahu nuk ua humb shpërblimin vepërmirëve.” (Et-Tevbe : 120)

Niveli i obligimit prej mjeteve dhe masave ligjore

Nga ajo që thamë më parë, kërkohet që mjetet dhe masat ligjore të shfrytëzohen varësisht se ku shpijnë ato, në dëm apo dobi:

- **Ndonjëherë mund të jenë të lejuara**, si, fitimi hallall, shijimi i të mirave dhe të bukurave dhe ushqimi për të shuar urinë, e ndonjëherë janë obligative, si, abdesi për namaz.

- **Ndonjëherë janë haram**, si f.v., vjedhja për të shpenzuar për familjen pa pasur nevojë.

Mua më bëhet e qartë se prej asaj që u përmend, kuptojmë se:

- mjeti haram është haram dhe

- mjeti obligativ është obligativ (vaxhib).

Mirëpo kjo është e ndërtuar mbi rregullin e shumicës absolute të dijetarëve të cilët në temën e ligjit kanë vendosur rregullin: **“Ajo çka nuk realizohet obligimi përpos me të, ajo është obligative.”**:

- Imoraliteti është haram, andaj, shikimi në pjesën e turpshme të gruas së huaj është haram sepse ai shikim të shpie në imoralitet.

- Namazi i xhumasë është obligim dhe po ashtu shkuarja për namaz të xhumasë është obligativ.

- Ndërprerja e shitblerjes për të shkuar në namazin e xhumasë është farz.

- Haxhi është farz, angazhimi në shtëpinë e shenjtë dhe dispozitat e haxhit janë farz për haxhin.

Kjo nga shkaku se Ligjvënësi kur t’i obligoj robërit për një çështje, çdo gjë që shpie në atë çështje, kërkohet me kërkesën paraprake, dhe, kur njerëzit ndalohen për një çështje, çdo gjë e cila shpie te ndodhia e asaj ndalese është e ndaluar.

Vazhdimisht është thënë se: obligimet e sheriatit janë:

- ose kërkesa,

- ose ndalesa.⁵

Nëse e shohim se Ligjvënësi e ka ndaluar një çështje, në atë moment ndalon çdo gjë që shpie deri te ajo ndalesë dhe, nëse e shohim se Ligjvënësi e urdhëron një çështje, në atë moment urdhëron çdo gjë që shpie deri te ajo urdhëresë.

Ai ka urdhëruar për dashuri ndërmjet njerëzve dhe ka ndaluar urrejtjen dhe përçarjen në mes tyre, kështu që ka ndaluar çdo gjë që shpie në urrejtje dhe në përçarje.⁶

Ka ndaluar që njeriu ta fejojë të fejuarën e vëllait (në fe) të tij ose që ta blejë atë send që është duke e blerë vëllai i tij.⁷ Kjo nuk është asgjë tjetër pos ndalesë veprimeve të tilla si masë parandaluese e urrejtjes.

Ibn Kajimi është angazhuar në sqarimin e kësaj baze ligjore, vërtetimin dhe ligjësimin me argumente të sheriatit.⁸

Dallimi në mes të “masës (mjetit) ligjore” dhe “bazës juridike”

Ka dallim në mes të masës ligjore dhe bazës ligjore.

Baza e një çështjeje është çështje mbi të cilën varet ekzistenca e diçkaje. Vërehet qartë se prej saj varet realizimi i qëllimit të kërkuar.

Sa i përket masës ligjore, vërehet qartë se me të nënkuptohet arritja dhe realizimi i qëllimit nëpërmjet ligjit. Shembull:

Themeli i murit i cili mbështetet në të është **baza**.

Shkalla nëpërmjet së cilës hipet në kulm është **mjeti**.

Dallimi vërehet qartë në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ
إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا ۖ وَلَا يَضْرِبْنَ بِخُمُرِهِنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ ۖ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ
إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ أَوْ آبَاءِ بُعُولَتِهِنَّ أَوْ أَبْنَائِهِنَّ أَوْ أَبْنَاءِ بُعُولَتِهِنَّ أَوْ
إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي إِخْوَانِهِنَّ أَوْ بَنِي أَخَوَاتِهِنَّ أَوْ نِسَائِهِنَّ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ
أَوِ التَّابِعِينَ غَيْرِ أُولِي الْإِرْبَةِ مِنَ الرِّجَالِ أَوِ الطِّفْلِ الَّذِينَ لَمْ يَظْهَرُوا عَلَىٰ
عَوْرَاتِ النِّسَاءِ ۖ وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ ۖ
وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهُ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtove nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femra ose fëmijët që nuk janë të pjekur për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të mos zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.” (En Nur : 31). Kjo është prej

masës ligjore dhe nuk është prej **bazës ligjore** sepse dëmtimi prej sprovës së mashkullit prej femrës nuk varet prej kërcitjes së femrës me taket e saj me hall-halle, mirëpo ajo është masë parandaluese e atij dëmtimi sepse çështja e atij veprimi shpie deri aty.

Po ashtu thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدْوًا بِغَيْرِ عِلْمٍ ۚ كَذَلِكَ زَيْنًا لِكُلِّ أُمَّةٍ عَمَلُهُمْ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّهِمْ مَرْجِعُهُمْ فَيُنَبِّئُهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.” (El En’am : 108). Edhe kjo nuk është prej **bazës ligjore** sepse ofendimi i idhujtarëve i cili bëhet për Zotin e të gjithë botëve nuk varet direkt nga ajo se besimtarët e ofendojnë zotin e idhujtarëve dhe idhujt e tyre, mirëpo ofendimi i besimtarëve ndaj atyre zotave falsë është **masë ligjore** e cila shpie në ofendimin e idhujtarëve drejtuar Zotit të vërtetë.

Në **bazën ligjore** në të cilën varet ekzistimi i dëmtimit, nuk është e patjetërsueshme që të shkaktohet dëmtim.

Në **masën ligjore** me të cilën mund të arrihet qëllimi nuk është e patjetërsueshme që me atë masë të realizohet ai dëmtim.

Në bazë të kësaj, baza e dëmtimit mund të ndodhë edhe pa qenë çështja e masës parandaluese e cila shpie deri te ai dëmtim, si f.v., udhëtimi për mëkatim, ajo varet nga kalimi i distancës, vetëm se çështja e udhëtimit nuk është shkak që të dërgon në mëkat.

Mund të ndodhë që edhe **baza ligjore** edhe **masa ligjore** të kryqëzohen në një çështje, si f.v:

- pirja e pijes alkoolike shpie deri te dëmtimi, e edhe deri te humbja e vetëdijes (mendjes).

- Prostitucioni shpie deri te përzierja e gjenit.

Secila prej tyre është e dënueshme edhe me bazë ligjore.⁹

Baza e dispozitës së gjykimit në masa ligjore

Çdo veprim kontraktual të cilin e vepron njeriu, në vete përmban dy anë:

- Anën e cila të obligon kryerjen e veprimit; dhe
- Anën e qëllimit dhe të mjetit material të e cila shpie ai veprim.

Shatibiu e ka formuluar rregullin e masave ligjore në çështje tjetër e ajo është: **“Vështrimi në qëllimet e realizimit të veprimeve llogaritet qëllim ligjor.”** Nga kjo kuptohet se baza e ligjit është kryerja dhe jo detyrim në masën ligjore. Kjo do të thotë se shikohet në rezultatin e veprimit:

- nëse rezultati është dobi, atëherë mjete ligjor është i lejuar ligjërisht;
- nëse rezultati është dëm ose shkatërrim, ajo masë është e ndaluar ligjërisht.¹⁰

Kjo nga shkaku se:

- interesi është i kërkuar dhe kërkohet çdo gjë e cila shpie deri aty;
- dëmi është i ndaluar dhe po ashtu është e ndaluar çdo gjë që shpie aty, qoftë edhe nëse qëllimi është i mirë dhe nijeti i drejtë.

Bazuar në këtë, umeti patjetër duhet të mësoj profesionet e shumëllojta sepse ato janë masa të interesit të përgjithshëm në të cilat varet zhvillimi shoqëror. Kjo është tematikë e çlirimit të masave. Karafiju i ka përmendur shembujt e çlirimit të masave të cilat do t'i tregoj në vijim:¹¹

1. Lejohet të paguhen luftëtarët e armikut për t'i çliruar robërit muslimanë edhe pse në esencë pagesa e luftëtarëve të armikut është haram (e ndaluar) sepse forcohet armiku me ato mjete materiale dhe e dëmton shoqërinë muslimane, por është e lejuar që të largohet dëmi më i madh, të çliruarit e robërve musliman nga robëria dhe forcimi i shoqërisë islame me ta.

2. Lejohet t'i jepen të mira materiale personit si ryshfet, e cila në esencë është haram, me qëllim që të shpëtoj nga mëkati në të cilën frikësohet që do të bie, pasi dëmi i atij mëkati është më i madh se sa dhënia e atij ryshfeti poqëse nuk do të kishte pasur mundësi ta paguaj atë ryshfet. Këtë e kanë lejuar shumica e Malikijve dhe Hanbelijve.

3. Lejohet t'i jepen të mira materiale shtetit sulmues, për t'u liruar prej torturimeve dhe rreziqeve nëse shoqëria islame nuk ka forcë t'i çliroj ato vende prej atij shteti. Këto raste të dhënies së të mirave materiale në esencë janë mëkat apo të ndaluara, por janë lejuar për të penguar dëmin më të madh ose për të sjell dobi më të madhe.

4. Lejohet donacioni i të mirave materiale për haxhiun të cilit i ka humbur pasuria, me qëllim që ai të arrij në Qabe. Këtë e kanë lejuar disa Malikijë dhe disa Hanbelijë.

Shembuj të masave ligjore janë të shumta e prej tyre:¹²

1. Ndalesa e shikimit të femrave për shkak se shpie në prostitucion.
2. Ndalimi i gjykimit të gjykatësit me diturinë e tij sepse ky është gjykim me padrejtësi dhe është prej gjykimit të keq.
3. Sigurimi i ushqimit që të mos bartet më qëllim që të mos preket.
4. Dijetarët e Malikijve, Shafijve dhe Ahmedi e ndalojnë shitblerjen e armatimit në kohë trazirash dhe e shpallin të pavlefshëm sepse në të shumtën e rasteve ky lloj i shitblerjes llogaritet *mbështetje e agresivitetit*.
5. Malikijtë dhe Hanbelijtë deklarojnë që të mos i pranohet pendimi tradhtarit dhe mashtruesit i cili ka qenë i njohur për tradhti, e dihet se në islam kërkohet nga tradhtari që të pendohet dhe nëse pendohet kthehet në islam, dhe nëse nuk pendohet ekzekutohet, mirëpo mashtruesit tradhtarë të fesë veçohen nga ky proces sepse ato adresën e islamit e marrin si rrugë lajkatimi dhe shkatërrimi të besimit, si rrugë për përhapjen e risive dhe përhapjen e dezinformatave për t'i shkatërruar muslimanët, ata janë hipokritë andaj duhet të ekzekutohen si masë preventive për t'u shkatërruar dhe për të hyrë në greminën e së keqes.

Këto ligje parashikojnë rezultatin e veprimeve dhe dëmet të cilat shkaktohen prej tyre. Sa i përket çështjes e cila shpie në të keqe, në të shikohet ana e dispozitës për botën tjetër se a është mëkat për të dhe a dënohet në botën tjetër për atë mëkat?

Si shikohen masat ligjore në aspekt të përgjithshëm?

Mjetet apo masat ligjore në aspekt të përgjithshëm shikohen në dy anë:¹³

E para: shikohet në arsyen e cila e shpie personin në atë veprim, pa marrë parasysh se a është qëllimi i tij që të arrij te hallalli apo te harami.

E dyta: shikohet vetëm dëshira, duke mos i shikuar arsyet dhe qëllimet.

E para: Shikimi në arsye dhe qëllime. Kur kontrahetohet një kontratë me të cilën qëllimi nuk është që të jetë sipas shariatit por dëshirohet një çështje e ndaluar (haram), si p.sh., akti i kurorëzimit, por jo me qëllim që të ketë kurorë të përgjithmonshme, por me qëllim që pastaj ta shkurorëzoj që t'i lejohet shkurorëzuesit i cili e ka shkurorëzuar tri herë ose të lidh një kontratë shitblerjeje, por jo me qëllim të këmbimit të mallit me të holla por me qëllim që të bëjë lajkatim për të përfituar me të kamatë.

Në këto raste si dhe raste tjera të ngjashme, kontraktuesi llogaritet mëkatuar. Akti i tillë nuk lejohet fetarisht. Kjo është sa i përket raporteve të tij me Allahun.

Nëse paraqiten fakte të qëllimit të tij kur të lidhet kontrata, ai nijet llogaritet shkak për të pezulluar apo për ta shpallur aktin e pavlefshëm sepse nijeti llogaritet argument i qartë i cili paraqitet në kontratë dhe jo vetëm fjalët, bile edhe të vepruarit me atë nijet interpreton ato fjalë, sepse faktet e gjendjes e përcaktojnë qëllimin dhe pikësynimet dhe fjalët përdoren për të treguar qëllimet e kontraktuesve, kur eliminohen ato qëllime dhe llogariten vetëm fjalët, atëherë kemi eliminuar çka duhet të llogaritet dhe kemi llogaritur çka duhet eliminuar.

Në këtë rast vërehet se: në rend të parë shikohet shkaku i cili shpie në mëkatim, e pastaj nga aspekti i zhvlerësimit të veprimit nëse paraqitet dëshmia (fakti).

E dyta: Të shikuarit në dëshira dhe duke mos llogaritur arsyet dhe qëllimet. Këndvështrimi në vepra dhe përgjithësisht në rezultatin përfundimtar:

- Nëse ato veprime anojnë në anën e dobive të cilat janë qëllimet e marrëdhënieve reciproke të njerëzve, kjo kërkohet varësisht sa u përshtatet atyre qëllimeve.

- Nëse ato veprime anojnë në anën e dëmit, ato ndalohen varësisht sa janë të ndaluara ato qëllime edhe nëse masa e ndalesës është më e vogël në mjetin shfrytëzues.

Të shikuarit në dëshirat e këtyre animeve nuk është në qëllimin e vepruesit dhe të nijetit të tij por në rezultatin e veprimeve dhe frytin e tij, dhe varësisht prej nijetit njeriu ose shpërblehet ose dënohet në botën tjetër.

Nga aspekti i shikimit të parë dhe varësisht rezultatit dhe frytit, vepra e tij gjykohet në këtë dunja, e mirë apo e keqe, kërkohet ose pengohet, sepse kjo botë është ndërtuar për dobinë e njerëzve, dhe në barazi dhe drejtësi. Kush i ofendon idhujt, duke dashur ta adhuroj Zotin e Lartmadhëruar sinqerisht, Zoti i Lartmadhëruar ia llogaritet atë qëllim, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar e ka ndaluar një gjë të tillë nëse kjo nxitë idhujtarët që ata ta ofendojnë Allahun pa kurrfarë njohurie. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo popull veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.” (El En’am : 108)

Në këtë ndalesë vërehet se ndalesa ka të bëjë me rezultatin e veprës dhe jo me nijetin. Nga kjo argumentohet se ndalesa është në atë që shpie në mëkat dhe nuk shikohet vetëm nijeti, por te rezultati i cili prodhohet prej saj gjithashtu.

Esenciale për t’u marrë për bazë masat ligjore është të shikohet në qëllimin e veprave dhe merret për bazë dispozita për veprën e cila është në përputhshmëri me atë çka interpretohet, pa marrë parasysh a e ka pasur atë qëllim apo nuk e ka pasur atë qëllim:

- Nëse veprimi shpie në të lejuarën, ai veprim është i lejuar,
- nëse veprimi shpie vetëm në të keqen, ai veprim është i ndaluar, për shkak të rezultatit të atij veprimi edhe nëse bëhet e ditur se ai veprim është për të mirë dhe për nijet të sinqertë.

Ndonjëherë njeriu pikësynon të keqen nëpërmjet veprës së lejuar, atëherë ai mëkaton me mëkat në mes tij dhe Allahut, mirëpo askush nuk ka të drejtë ta gjykoj atë dhe veprimin e tij me ligj sheriatik, si p.sh., ai i cili e liron çmimin e një lloji të artikullit, që me veprimin e tij t’i dëmtojë tregtarët konkurrent. Pa kurrfarë dyshimi, ky veprim është i lejuar edhe pse ky është mjet i mëkatimit sepse me veprimin e tij i dëmton të tjerët, me të cilin veprim ka pasur po atë qëllim, mirëpo absolutisht nuk gjykohet veprimi i tij

si i pavlefshëm dhe nuk bën pjesë brenda dukurisë së ndalesës për të cilin dënohen në gjykatë edhe pse ai veprim nga aspekti i nijetit është mjet i së keqes ndërsa si dukuri, mund të jetë mjet në interes të veçantë dhe të përgjithshëm sepse pa kurrfarë dyshimi shitësi përfiton me tregtinë e tij dhe blerësit në përgjithësi përfitojnë nga ai lirim çmimi, e ndoshta edhe ndikon në lirimin e çmimeve, mirëpo imam Ahmedi një veprim të tillë e konsideron **mekruh** nëse kuptohet se me atë veprim ka për qëllim t'i dëmtoj tregtarët tjerë. Imam Maliku e ka **ndaluar** një veprim të tillë duke u bazuar në një raportim të Ibn Musajebit se: “Umeri r.a. kalon rreth Hatib bin Ebi Belteas, derisa ai shiste rrush të thatë në treg dhe i thotë: **“Ose ngrite çmimin ose largohu nga ky treg.”**”¹⁴ Koncepti i kësaj ka qenë se Hatibi e shiste mallin nën çmimin e të tjerëve, ndërsa Umeri e urdhëron ta nivelizoj me çmimin e të tjerëve ose të largohet nga tregu.

Shihet se parimi i masës preventive nuk shikohet vetëm në nijetin dhe qëllimet e dhunshme, por shikohet edhe interesi i përgjithshëm, ose në largimin e dëmit të përgjithshëm, ose shikohet në qëllimin dhe rezultatin, ose vetëm në rezultatin (e jo në qëllimin).

Shatibiju e ka presupozuar një shembull: Ku një person vepron një vepër për dobinë e tij e për të dëmtuar tjetrin dhe nuk është në pyetje as dobia e përgjithshme e as dëmi i përgjithshëm dhe thotë: Nuk ka dyshim se është i ndaluar qëllimi i dëmshëm, nga vetë ajo se është dëmtim, duke u bazuar në argumentin: **Në islam, as mos dëmtoni dhe as mos u dëmtoni.**

Mirëpo, ka mbetur të shikohet në atë vepër në të cilën janë bashkuar në të qëllimi i dobisë dhe qëllimi i dëmit të tjetrit, a ndalohet dhe a bëhet vepër e patolerueshme apo mbetet në dispozitën e saj fillestare - lejimi - dhe atëherë a ka mëkat në atë çka ka synuar? Kjo, me një fjalë i bie që, mund të paramendohet kundërshtimi rreth kësaj çështjeje dhe duhet që me angazhim dhe përpjekje të sqarohet:

- ose që të largohet ai veprim dhe të kalohet me një mënyrë tjetër për ta realizuar atë interes;

- ose largimin e dëmit i cili është bërë, dëm të cilin e ka dëshiruar ose jo.

Nëse është kështu, nuk ka dyshim se duhet penguar (ndaluar) atë veprim prej tij sepse nuk e ka pasur atë qëllim, por qëllimi ka qenë dëmtimi, por nëse nuk e ka pasur për qëllim që vetëm ta dëmtoj tjetrin, atëherë ka përparësi e drejta e furnizimit dhe e largimit të dëmit, e ai ndalohet nga qëllimi i dëmtimit, në të dy format¹⁵ ai pengohet të veprojë, ai ka mundësi që ta realizoj interesin nëpërmjet një rruge tjetër dhe jo prej pozitës së qëllimit

të keq e dëmtues, dhe duke ia diktuar veprimtarinë lejohet që të veprojnë sepse nuk ka rrugë tjetër përpos realizimit të interesit.

Pengimi i dëmit të përgjithshëm me sferën e dispozitës për këtë botë me masat ligjore

E kuptuam se te masat dhe mjetet ligjore, sa i përket si dispozitë e kësaj bote nuk llogaritet nijeti edhe pse kjo është çështje thelbësore në lejimin apo ndalimin e veprimit, vetëm se shikohet thelbësisht në rezultatin dhe frytet dhe:

- nëse rezultat i veprës është interesi i përgjithshëm është me obligueshmërinë e saj.

- nëse rezultati i veprës shpie në dëmtim ajo bëhet e ndaluar me ndalesën e saj sepse dëmtimi është i ndaluar ashtu siç është ndaluar çdo gjë që shpie në dëmtim.

- interesi është nevojë dhe çdo gjë që shpie te nevoja është e nevojshme. Objektivi për interesin është dobia e përgjithshme, dhe

- dëmi është vepra që sjell vuajtje për një shumicë njerëzish.

Në bazë të kësaj, nëse një person për interesin e tij personal dëshiron të veprojë diçka që shpie në dëmin e përgjithshëm ose që e pengon interesin e përgjithshëm, nevojitet që të ndalohej, kjo si masë preventive dhe duke e shikuar interesin e përgjithshëm prioritar ndaj atij sekondar,¹⁶ si p.sh., është e ndaluar që të bashkohen artikujt para se të dalin në treg edhe pse në esencë kjo është e lejuar pasi që është shitje dhe blerje, mirëpo nëse kjo u lejohet njerëzve do t'u vështirësohej veprimtaria e drejtë dhe nuk do të ishte liria e barabartë e të vepruarit. Nëse do të lejohej do të ishte dëm i përgjithshëm dhe ndalimi i këtij lloji të tregtisë bëhet si masë preventive dhe bëhet ndalesë e përgjithshme edhe pse disa tregtar të cilët takohen e kanë nijetin e sigurtë sipas tyre, mirëpo më larg se kjo është e mundur të jetë manipulim për shitësin. Imam Maliku deklaroi se ata absolutisht kanë të drejtë të zgjedhin të takohen ose jo, pa marrë parasysh a ka manipulim në ato vendtakime apo jo.¹⁷

Si shembull është monopolizimi i artikujve ushqimor dhe nevojat e domosdoshme të njeriut. Kjo është e ndaluar me hadithin e Muhamedit a.s. **“Vetëm mëkatari monopolizon.”**¹⁸ Qeveria shtetërore e ndalon

monopolizimin e mallrave si parandalim të dëmtimit të shoqërisë dhe ai i detyron monopolistët që të shesin me çmim të arsyeshëm kur shoqëria ka nevojë për ato mallra dhe ndërhyrja e qeverisë në këtë çështje llogaritet si masë parandaluese e së keqes dhe vuajtjeve të cilat mund t'i përjetojnë shoqëria.¹⁹

Llojet e masave ligjore

Masat dhe mjetet parandaluese ndahen në bazë të dy formave.

Forma e parë: Në bazë të rezultatit final i cili rezulton në përgjithësi.

Forma e dytë: Në bazë të shkallës së dëmit të cilin e shkakton ai mjet.

Në librin “I’elamul Mukiijn” Ibn Kajimi e përmend formën²⁰ e parë ashtu siç e përmend Shatibiu në librin “Muvafekatë” formën e dytë.²¹

Si i ndanë Ibn Kajimi masat varësisht prej llojit të rezultatit?

Varësisht prej llojit të rezultatit Ibn Kajimi i ndan masat në dy kategori:

1. Që të vendoset për të shkaktuar dëm, si f.v., pirja e alkoolit ndikon në dëmin e humbjes së vetëdijes, shpifja ndikon në dëmin moral, prostitucioni shpie në përzierjen e farës dhe shkatërron familjen, e të ngjashme.

2. Që të vendoset për të ndikuar në çështje të lejuar ose të pëlqyer dhe e përdor mjetin e ndaluar ose me qëllim ose pa qëllim.

E para: Ai i cili kurorëzohet me qëllim që t’i lejohet gruaja burrit të parë i cili e ka shkukurëzuar ose që të kontrakton kontratë shitblerje me qëllim kamate.

E dyta: Ai i cili i ofendon idhujtarët drejtpërdrejtë.

Pas kësaj, kjo kategori është dy llojesh.

E para: Që dobia e interesit të jetë më e madhe se dëmi.

E dyta: Që dëmi të dominoj ndaj interesit. Në këtë lloj kemi katër nënlloje:

a) Masa ligjore e cila përdoret që në vetvete padyshim shkakton dëmin si f.v. pirja e alkoolit shpie në dëmin e alkoolit, prostitucioni shpie në përzierjen e farës së embrionit dhe prishjen e jetës bashkëshortore dhe është sulm i drejtpërdrejt ndaj nderit dhe shkakton armiqësi në mes njerëzve.

b) Masa e cila përdoret për të ndikuar në lejim, por që qëllimi është që nëpërmjet saj të arrihet të dëmi, si f.v., kurorëzimi me qëllim lejimi për burrin tre herë shkukurëzues ose shitblerja me qëllim realizimi të kamatës.

c) Çka vendoset e lejuar dhe që nuk ka për qëllim të arrihet deri te dëmi, por që në të shumtën e rasteve realizohet dëmi, ajo dominon në anën e realizimit të dëmit ndaj dobisë, shembull, ofendimi i zotave të idhujtarëve në prani të tyre.

d) Çka është vendosur për lejim por që shpie në dëmtim, por që ana e dobisë dominon ndaj anës së dëmit, si f.v., shikimi në të fejuarën dhe prezenca afër saj.

Si i ndan Shatibiu masat ligjore varësisht prej forcës së rezultatit?

Varësisht prej të keqes dhe dëmit i cili shkaktohet, Shatibiu masat ligjore i ndan në katër lloje:

1. **Ajo çka e sjellë të keqen kategorike**, si f.v., hapja e gropës pas dere në errësirë, ashtu që ai i cili e hapë atë derë domosdo do të bie në atë gropë, e të ngjashme. Kjo ndalohet, kush e vepron llogaritet se ka bërë vepër penale dhe dënohet për vepër penale, ose për shkak të mungesës së të kuptuarit të drejtë të çështjeve ose për shkak të pikësynimit të shkakimit të atij dëmi.²²

2. **Ajo çka sjell dëm, por rrallë herë**, si f.v., hapja e gropës në një vend që vështirë se mund të bie ndonjë njeri në të ose shitjen e ushqimit që në të shumtën e rasteve nuk e dëmton ndonjë njeri. Kjo mbetet në bazën e saj të lejimit sepse Ligjvënësi i ka formuluar ligjet që në të shumtën e rasteve të sjellin dobi dhe nuk llogaritet ajo se ato ligje ndonjëherë sjellin dëm, pasi që çështjet nuk janë absolut të dobishme dhe as absolut të dëmshme dhe zakonisht nuk mund të gjendet ndonjë dobi që nuk e ka edhe ndonjë dëm. Shatibiu thotë:²³ “Këtu nuk llogaritet qëllimi i personit se a e ka për qëllim sjelljen e dëmit apo largimin e dëmit, duke e ditur se ndonjëherë mund të ketë dëm prej atij veprimi, mungesë në parashikim dhe nuk e ka pasur për qëllim të ndodh dëmi. Kështu pra, vepra mbetet në bazën e saj ligjore.”

3. **Ajo çka sjell dëm e në të shumtën e rasteve dhe jo rrallë herë dhe dominon ana e dëmtimit dhe e shkatërrimit**, si f.v., shitja e armëve personave në luftë, shitja e rrushit për fabrikën e alkoolit.²⁴ Në të shumtën e rasteve ky gjykim i kësaj gjendjeje i bashkëngjitet diturisë së prerë për çështjet si në vijim:

- a) Paragjykimi në ligjet praktike bën pjesë në gjykimin faktik. E shihet qartë se në këtë kemi këtë çështje.
- b) Ligjvënësi ka tekstualizuar për masat ligjore të cilat do t'i përmendim më vonë. Ky lloj bën pjesë brenda kornizës së tekstit sepse koncepti i masave ligjore parandaluese është se mund të ndodhë shkatërrimi. Rezerva e ndodhisë së shkatërrimit obligon që të veprohet me atë që ndodh në të shumtën e rasteve.
- c) Me lejimin këtij lloji do të thotë të ndihmohet mëkati, agresioni dhe e ndaluar.

4. **Ajo çka sjell dëm jo në të shumtën e rasteve, as rrallë herë, por në të shumtën absolute të rasteve**, si f.v., shitblerja me këste sepse kjo shpie në kamatë në të shumtën absolute të rasteve dhe jo në të shumtën e rasteve apo rrallë herë. Kjo çështje duhet të analizohet dhe të vështrohet ose të shikohet baza e lejimit të blerjes dhe të lejohet (shitblerja). Të këtij drejtimi janë Shafiijtë dhe Ebu Hanife, se te ta njohuria apo të paramenduarit se mund të ndodhë dëmi është i ndaluar, pasi që në këtë rast ekziston vetëm mundësia në mes të ndodhjes dhe mosndodhjes së dëmit dhe nuk ka argument i cili i jep përparësi njërës ndaj tjetrës dhe nuk mund të miratohet ndalesa përpos se me dituri apo paragjykim, po ashtu veprës nuk lejohet t'i bartet barra e dëmit të paqëllimshëm dhe nuk mund të përkufizohet se mund t'i largohet dëmit sepse nuk është në shumicën absolute të rasteve por shumë herë mund të ndodhë dëmi. Ose të shikohet baza se shumë herë mund të ndodhë dëmi dhe ndalohet. I këtij drejtimi është Maliku dhe Ahmedi, e kjo për shkak të tri rrethanave:²⁵

a) Në këtë shitblerje shikohet se shumë herë qëllimi është kamata, mirëpo qëllimi në vetvete nuk mund të saktësohet, ose mund të paragjykohet se mund të ndodhë dhe dëmi ndryshon prej rastit në rast. Dhe alternativa se shumë herë mund të ndodhë dëmi prej rastit në rast e bën që të jetë afër ndodhjes së saj dhe duhet pasur kujdes që mos të veprohet ai veprim sepse ndodhia e shumtë e dëmeve në alternativ e sjell në nivelin e çështjeve që mendohet se ndodhë në të shumtën e rasteve ose e bën që të jetë dituri e prerë në traditë sepse i bashkëngjitet rastit të paragjykimit se mund të ndodhë në të shumtën e rasteve dhe diturisë se mund të ndodhë shumë herë dhe dihet se “largimi i dëmit ka përparësi ndaj sjelljes së dobisë.”. E shumta e ndodhisë llogaritet në bazë të hadithit të nënës së djalit

Zejd bin Erkem, të cilin hadith do ta tregoj në temën “Argumentimi i masave ligjore parandaluese”.

b) Në shitblerjet me këste ndeshen dy baza sepse në esencë shitblerja është e lejuar, mirëpo këtu e kemi bazën tjetër, sigurimi i njeriut që të mos dëmtohet prej tjetrit. I jepet përparësi bazës së dytë për shkak se shumë herë mund të ndodhë dëmi, për këtë arsye duhet të ndalohen këto lloje të shitblerjeve dhe nxirret nga baza e lejuar e veprimit (e cila ka qenë më parë) në bazën e dytë të ndalimit të veprimit si ligj parandalues i së keqes dhe dëmit.

c) Ekzistojnë tekste të shumta në ndalimin e çështjeve të cilat kanë qenë të lejuara sepse shumë herë ato çështje shkaktojnë dëme edhe pse nuk janë në të shumtën e rasteve si dëme apo që kategorikisht shkaktojnë dëme.

- Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar të pihen lëngjet që rrjedhin nga lëngjet, për shkak se është e mundur që ato pije të bëhen alkool dhe nuk dihet se a janë alkool, e ndalesa është bërë që të mos lejohet keqpërdorimi.²⁶

- Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar të vetmuarit me gruan e huaj dhe që femra të udhëtoj me njeri të huaj pos me atë që e ka kujdestar apo të afërm që e ka të ndaluar të martohet me të.²⁷

- Ka ndaluar ndërtimin e xhamive në varreza dhe faljen e namazit në varreza²⁸ dhe të martuarit së bashku me gruan dhe hallën e saj apo me tezen e saj dhe ka thënë: **Nëse ju veproni kështu, i ndërpritni lidhjet farefisnore.**²⁹

- Ka ndaluar që të martohet gruaja në iddet për shkak se gruaja mund të gënjejë gjatë kohës së iddetit.³⁰ Gruaja me iddet ndalohet që të parfumohet, të zbukurohet dhe çështjet tjera të cilat shpijnë në martesë.³¹

- Ka ndaluar shitblerjen e papërcaktuar.³² Ka ndaluar që t'i jepet dhuratë borxhliut.³³ Ka ndaluar që të trashëgojë vrasësi i trashëgimtarit.³⁴

- Ka ndaluar të agjërohet dita e fitr bajramit,³⁵ e raste të tjera, si masa parandaluese.

Këto raste, pejgamberi s.a.v.s. i ka ndaluar nga frika se mund të ndodhë dëm i cili mund të rezultojë edhe pse nuk mund të gjykohet se ndodhin ose që sigurisht ndodhin. Shatibiu ka thënë: “Sheriati është i ndërtuar mbi bazën e moslejimit dhe të përkujdesjes se ndoshta veprimet shkaktojnë dëm.”

Argumentimi i masave parandaluese dhe mendimet e dijetarëve

Dy imamët Maliku dhe Ahmedi, masat ligjore i llogarisin si bazë në usuli fikh.³⁶

Ibn Kajimi ka deklaruar se *masat parandaluese janë një e katërta e fesë*.³⁷

Shafiiju dhe Ebu Hanife³⁸ në disa raste kanë vepruar me të, ndërsa në disa raste tjera e kanë refuzuar.

Po ashtu edhe shiitët³⁹ veprojnë me argumentin e masave parandaluese.

Ibn Hazmi, themelues i drejtimit dhahirijë, masat ligjore absolutisht nuk i pranon.

Argument se Shafiiju vepron me masat parandaluese është thënia e tij në librin “**El-Um**”⁴⁰ dhe në gjykimin e parandalimit të përdorimit të ujit me qëllim të parandalimit të infektimit, e cila ndalesë është mëshirë prej Allahut dhe përmban dy kuptime:

E para: Ajo masë e cila përdoret për të lejuar atë çka e ka ndaluar Allahu, nuk lejohet, pastaj vazhdon e thotë: “Nëse kjo është kështu, atëherë kemi të bëjmë me atë se çka aprovohet si masë për të lejuar apo ndaluar i ngjanë kuptimit të hallallit dhe haramit.”⁴¹

E dyta: Shafiiju deklaron se ndonjëherë nuk prehet kurbanin nëse proklamohet se nuk është obligim, mirëpo sa i përket çështjes së llojit të shitblerjes “**AXHAL**”, te ai ka argument tjetër i cili e kundërshton të jetë masë parandaluese dhe ai i jep prioritet argumentit tjetër dhe vepron me të dhe për shkak të atij argumenti vepron me të dhe nuk vepron me masat parandaluese, e ai argument është “**Nuk akuzohet për ndalesë ai të cilit nuk i dihet qëllimi i tij.**”.

Maliku dhe të tjerët veprojnë me rregullin se, akuzohet për shkak të paraqitjes së veprimit të talljes, kjo tregon se ai e ka për qëllim veprën e ndaluar.

Argumentet

Argumentet e pranuesve: Këtu do t'i përmendi argumentet e pranueseve të masave ligjore dhe do ta veçoj një temë të argumenteve të mospranuesve në adresimin “Ibn Hazmi dhe masat ligjore”.

Argumentet e deklaruesve të masave ligjore janë argumente nga **Kur’ani dhe suneti**.

1. **Sa i përket argumenteve prej Kur’anit** është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقُولُوا رَاعِنَا وَقُولُوا انظُرْنَا وَاسْمَعُوا ۚ وَلِلْكَافِرِينَ
عَذَابٌ أَلِيمٌ

“O ju që keni besuar, mos thoni: Raina - po thoni: Undhurna, dhe respektoni! Mosbesimtarët kanë dënim të dhimbshëm.” (El Bekare : 104)

Pjesa “**RAINA**” është aktivi i fjalës “**RAUNË**” fjalë të cilën e përdorin jehuditë për ta ofenduar pejgamberin s.a.v.s.

Pastaj thënia tjetër e Zotit të Lartmadhëruar:

وَأَسْأَلُهُمْ عَنِ الْقَرْيَةِ الَّتِي كَانَتْ حَاضِرَةَ الْبَحْرِ إِذْ يَعْدُونَ فِي السَّبْتِ إِذْ
تَأْتِيهِمْ حِيتَانُهُمْ يَوْمَ سَبْتِهِمْ شُرَعًا وَيَوْمَ لَا يَسْبِتُونَ ۚ لَا تَأْتِيهِمْ ۚ كَذَلِكَ
نَبْلُوهُمْ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ

“Dhe pyeti ti (Muhamed) për fshatin, që ishte në breg të detit e ata e shkelën rendin e të shtunës (që e kishin të ndaluar gjuajtjen e peshqve), kur në të shtunën e tyre peshqit iu vinin sheshazi mbi ujë, e në ditën që nuk festonin nuk ju vinin. Ja, kështu i sprovuam ata, sepse ishin mëkatarë.” (El-Earaf : 163).

2. Argumentet prej sunetit

Thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Lëre atë e cila të bën të dyshimtë për atë e cila nuk të bën të dyshimtë.”**⁴²

Thënia tjetër: **“Hallalli është i sqaruar, po ashtu edhe harami është i sqaruar, vetëm se në mes tyre ka gjëra të dyshimta.”**⁴³

“Besimtarët largohen nga gjërat e dyshimta.”⁴⁴

“Mëkat është ajo çka ta ngushton gjoksin tënd dhe nuk e pëlqen që të ta shpalosin njerëzit.”⁴⁶

“Pyete zemrën tënde edhe nëse tëspjegojn spjeguesit”⁴⁷

“Pyete zemrën, nëse të sprovonjë sprovuesit.”⁴⁸

“Prej mëkateve më të mëdha është që të ofendoj njeriu nënën e vet. Është pyetur: O i dërguar i Allahut si mund ta ofendoj njeriu nënën e tij. Është përgjigjur: - E ofendon babën e tjetrit e ai ia ofendon babën dhe e ofendon nënën e tjetrit e ai ia ofendon nënën.”⁴⁹

Ibn Tejmije argumentohet për masat parandaluese me argumente tekstuale (foljore) dhe praktike të sunetit, e ato janë:

1. **Hadithi** i lartpërmendur në lidhje me ndalimin e sharjes së njeriut prindërit e të tjerëve që të mos jetë shkak që t'i shahen prindërit e tij sepse sharja e tjetrit ndikon në sharjen ndaj tij.

2. Ligjvënësi ka ndaluar fejesën e gruas me iddet sepse kjo do të shpinte edhe deri te martesë me gruan në iddet.

3. Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen dhe huazimin së bashku edhe pse nëse secila procedohet veç e veç është e vlefshme. Kjo nga shkak se mund të shkaktoj kamatën.

4. Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar që borxhdhënësi ta pranojë dhuratën nga borxhmarrësi, nga shkak se mund ta llogarisë në borxh.

5. Ligjvënësi ka ndaluar që vrasësi i trashëgimtarit të trashëgoj prej tij me qëllim që të mos jetë vrasja përshpejtim i trashëgimisë.

6. Sahabët janë pajtuar për ekzekutimin e shumë njerëzve për vrasjen e një njeriu edhe pse këtu qëndron pabarazia. Kjo, që të mos jetë një formë apo masë veprimi për krime dhe pastaj të mos ketë dënime.

7. Zoti i Lartmadhëruar ia ka ndaluar pejgamberit s.a.v.s. që të lexoj haptazi në periudhën e Mekes, që të mos fyhet: Zbritësi i Kur'anit, Kur'ani dhe ai të cilit i është zbritur.

Pastaj Ibn Tejmije vazhdon komentin dhe thotë: Tema për masat parandaluese është çështje e gjerë e cila nuk mund të përkufizohet dhe nuk i kemi përmendur dëshmitë e kësaj baze për të cilat janë pajtuar dijetarët dhe janë të tekstualizuara ose që është gjurmuar në fillim të veprimeve që janë shpërndarë prej tyre sepse çështjet sekondare për të cilat janë pajtuar, disa prej atyre çështjeve argumentojnë këtë bazë ligjore dhe disa prej atyre nuk argumentojnë këtë bazë ligjore.

Përpos këtyre argumenteve ka argumente tjera të shumta të cilat Ibn Kajimi i ka përmendur, sa që i ka sjellë nëntëdhjetë e nëntë forma të cilat tregojnë për parandalimin ligjor dhe të ndaluarit e veprimeve që sjellin dëm.⁵⁰

Analiza e boshtit të mospajtimeve të dijetarëve për masat ligjore

Dijetarët janë pajtuar se absolutisht nuk lejohet bashkëveprimi për mëkat dhe armiqësi sepse ajo çka i shpie muslimanët në shkatërrim është e ndaluar, si f.v., hapja e gropave në vende publike ose helmimi i ushqimit të tyre.

Po ashtu janë pajtuar se nuk lejohet sharja e idhujtarëve sepse mund të jetë shkak që të shahet Allahu, sipas thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët) pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.” (El En’am : 108) e të ngjashme, prej çështjeve për të cilat janë pajtuar se ndalohen të bazohen në ta.

Janë pajtuar se rruga e cila shpie në të mirë dhe në të keqe dhe në veprimin e tij ka dobi për njerëzit, nuk është e ndaluar, si f.v., mbjellja e rrushit, sepse rrushi shpie në prodhimin e alkoolit, mirëpo prej fillimit ajo mbjellje nuk e ka pasur atë qëllim, por dobia prej mbjelljes së tij është më e madhe se sa dëmi prej saj. Në këto raste merret për bazë e shumta.

Shembull tjetër kemi, fqinjësia me shtëpitë prej të cilave krijohet frika e rënies në imoralitet (prostitucion).⁵¹

Bosht i mospajtimit është lloji i katërt të cilin e përmend Shatibiu, e ato janë veprimet që nga aspekti i jashtëm janë të lejuara, por kur akuzohen vërehet se me to arrihet çështja e ndaluar.

Po ashtu edhe lloji i dytë të cilin e përmend Ibn Kajimi. Divergjenca përkufizohet posaçërisht në shitblerjen e quajtur “AXHAL”⁵² ose shitblerja “INIJN”.⁵³ Shembull: Kur shitësi e shet artikullin për dhjetë derhem deri në një afat të caktuar, për ta blerë atë për pesë derhem me pagesë të menjëhershme.

Thuhet se llojet e këtyre shitblerjeve mund të arrijnë deri në njëmijë raste dhe ato lloje të shitblerjeve mund t’i ilustron me shembuj.

Çdo çështje e lejuar e cila shpie te dëmi si f.v., kur është e domosdoshme të shikohet një grua e huaj ose të bisedohet me të, pasi që kjo mund të jetë shkak për prostitucion.

Në shikim më të thellë, pika e kundërshtimeve nuk është në këto shitblerje, që kuptohet se prej tyre qëllimi është arritja deri te kamata dhe kjo nuk lejohet asnjëherë por kundërshtimi është në rastet kur nuk vërehen arsyet të cilat tregojnë se qëllimi është te arritja e çështjes së ndaluar.

Malikijët dhe Hanbelijët,⁵⁴ këto shitblerje i shpallin të pavlefshme sepse vet kontrata tregon argumentim se qëllimi është te kamata sepse pikësynimi me lidhjen e këtyre kontratave është shitblerja e artikullit me pesë derhem në dorë ndërsa në dhjetë derhem deri në një afat të caktuar. Këmbimi i artikujve në këtë formë do të ishte shaka dhe nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Sa i përket Ebu Hanifes, ai edhe pse nuk thotë se është dispozitë e masës preventive, ai këto shitblerje i shpallë të pavlefshme, në bazë të një baze tjetër ligjore, e ajo është se, nëse paraja apo pagesa nuk është bërë, nuk është fuqizuar shitblerja e parë, ndërsa kontrata e dytë duhet të ndërtohet mbi të, që do të thotë se shitësi i parë nuk mund ta blejë sendin të cilin nuk e posedon, kështu që shitblerja e dytë mbetet kontratë e pezulluar dhe çështja interpretohet si shitblerje e sendit të pesë derhemëve e që nëse afatizohet shitet për dhjetë derhemë dhe quhet kamatë dyfishuese, për kamatë shtesë së bashku, kështu edhe kontrata e dytë shpallet e pavlefshme sepse e ka kuptimin e të vepruarit me kamatë.

Sa i përket Shafijëve, për në këtë botë, këto lloje të shitblerjeve janë të vlefshme, ndërsa ana e qëllimit të brendshëm të mëkatit dhe e dënimit mbetet për botën tjetër, që do të thotë se kontrata është haram sepse është e ndaluar, mirëpo ndalesa nuk e shpallë të pavlefshme çdo shitblerje e cila

shpie në shkaktim të dëmit, po ashtu edhe të çdo veprimi i cili shpie në mëkat. Të dy kontratat janë të vlefshme përderisa të paraqitet argument se qëllimi i tyre është kamata e ndaluar.⁵⁵

Në analizën e këtij mospajtimi më ka ndihmuar ajo çka është transmetuar nga dy dijetarë të drejtimit Malikij, Kurtubijut dhe Karafijut:

Kurtubiju deklaron:⁵⁶ Ligjin parandalues e përkrahin Malikijtë dhe shokët e tyre, mirëpo shumica e njerëzve e kanë kundërshtuar esencën e saj, mirëpo në shumicën e rasteve sekondare në praktikë kanë vepruar, më pastaj është vërtetuar boshti i mospajtit, dhe vazhdon e thotë: Dihet se çdo gjë e cila shpie te e ndaluara

- ose shpie në ndalesën në formë kategorike
- ose nuk shpie në ndalesën në formë kategorike.

Sa i përket të parës (që shpie në ndalesën kategorike), nuk është prej kësaj çështjeje (masës ligjore) por është prej çështjes së përfundimit të saj i cili është harami kështu që patjetër duhet larguar prej saj. Kjo çështje është haram nga rregulli i haramit (jo nga masa ligjore).

Ajo çka plotësohet vetëm se me veprën obliguese, ajo vepër është obliguese. Ajo çka është e patjetërsueshme (që të shpie në mënyrë kategorike):

- Ose është vepër që shpie në ndalesë në të shumtën e rasteve;
- Ose që mund të ketë dobi;
- Ose që dëmi dhe dobia janë të një niveli (të barabarta).

Kjo është ajo që te ne quhet **masë ligjore**.

Sa i përket kësaj, patjetër se duhet të qëndrohet larg.

Sa i përket të dytës (nuk shpie në ndalesën në formë kategorike) dhe të tretës, shokët e tij kanë dhënë mendime të ndryshme, disa prej tyre e shohin varësisht prej situatës, ndoshta e quajnë: akuzim jo i plotë dhe prej veprimeve të dobëta që shpijnë në ndalesë.”

Karafiju deklaron:⁵⁷ “Maliku nuk është i vetëm në këtë çështje, por secili e thotë kështu. Nuk është specifike e Malikut vetëm pse ata kanë shtuar diçka në të, dhe vazhdon e thotë:

- Ka prej gjërave që parandalohen, e ato janë të cilat janë prej ixhmait, si f.v., hapja e gropave në rrugë ku kalojnë muslimanët, helmimi i ushqimit të tyre, sharja e idhujve para atij të cilit dihet se pastaj do ta shajë Allahun.

- Ka prej gjërave të cilat anulohen prej ixhmait si masa parandaluese. Këtu bëjnë pjesë: mbjellja e rrushit, kjo veprimtari nuk ndalohet edhe pse ekziston frika se mund të prodhohet alkool dhe edhe pse është veprimtari edhe për haram.

- Ka prej gjërave për të cilat kanë dhënë mendime të ndryshme, si f.v., aktet e shitblerjes së llojit “AXHAL”, ne nuk themi se nuk është veprim i cili shpie në dëm dhe i kemi kundërshtuar të tjerët për bazën e çështjes. Për parandalimet ligjore ne jemi deklaruar më shumë se sa të tjerët sepse parandalimet janë posaçërisht mendimet tona. Ai (vazhdon) thotë: Me këtë e dimë pavlefshmërinë e argumentimit të shokëve tonë për Shafiijtë në këtë çështje, me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët) pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo popull veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.” (El En’am : 108)

dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَقَدْ عَلِمْتُمُ الَّذِينَ اعْتَدَوْا مِنْكُمْ فِي السَّبْتِ فَقُلْنَا لَهُمْ كُونُوا قِرَدَةً خَاسِئِينَ

“Ju tanimë e keni të njohur çështjen e atyre nga mesi juaj që nuk respektuan (urdhrin) në të shtunën, e Ne u thamë: Shndërrohuni në majmunë të përbuzur!” (El Bekare : 65)

I ka mallkuar nga shkaku se ata kanë shfrytëzuar masë të palejueshme për të peshkuar në ditën e diel pasi që rrjetat i kanë lëshuar ditën e xhuma.

Pastaj kemi thënien e peygamberit s.a.v.s.: **“Nuk lejohet dëshmia e armikut.”**⁵⁸ nga shkaku se mund të dëshmojë rrejshëm.

Po ashtu e ka ndaluar dëshminë e prindërve për fëmijët e tyre⁵⁹ dhe thotë: Ne kemi thënë se këto argumente nuk janë të vlefshme për boshtin e debatit sepse këto tregojnë se merret parasysht ligjërisht si masë parandaluese në aspekt global dhe për këtë çështje janë pajtuar dijetarët, por divergjenca qëndron në masat e veçanta parandaluese siç janë shitblerjet “AXHAL” dhe të ngjashme, kështu që nevojitet t’i përmendi argumentet e veçanta të boshtit të mospajtimit.

Argumentimi i ndalimit të shitblerjeve me kamatë

Shitblerjet me kamatë apo shitblerjet “AXHAL”, të cilat i kam treguar më herët quhen edhe shitblerje të llojit “INIJN” sepse është në mes të veprimtarisë së kamatës INIJN, si f.v., kur një person e shet një artikull me para të gatshme, e pastaj e blenë nga blerësi po të njëjtin artikull por për ta paguar me një afat të caktuar me çmim më të lirë. Diferenca në mes të çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes të jetë kamatë. Ata janë argumentuar për ndalimin e këtyre shitblerjeve nga masa parandaluese për kamatë, me hadithin e transmetuar nga dijetarët me senedin e plotë, se është transmetuar nga pejgamberi s.a.v.s. se ka thënë: **“Kur të mbështeten njerëzit në dërrhem dhe në dinarë dhe në shitblerjen e llojit të tregtisë “INIJN” dhe pasojnë bishtin e lopës dhe e lënë xhihadin në rrugë të Allahut, Zoti do t’u zbresë atyre sprova sa që nuk mund të shpëtojnë prej atyre sprovave deri sa të kthehen në fenë e tyre.”**⁶⁰

Malikijë i shtojnë edhe dy argumente e ato janë:

1. Këto shitblerje edhe pse nga këndvështrimi i jashtëm janë shitblerje, vetëm se, nëse njerëzit veprojnë me të madhe, qëllimi i tyre është të arrijnë të çështja e ndaluar por në fshehtësi, si shitblerja e llojit “SELEF” dhe shfrytëzimi i “SELEF-IT” është ndaluar, pasi është analoguar me parandalimin e së keqes për të cilat janë pajtuar se duhet ndaluar, ngase pika e përbashkët e secilës prej tyre është qëllimi për të arritur të e dëmshmjia, e aty arrihet me kontraktimin e tyre dhe me atë mënyrë.

2. Me hadithin të cilin e ka regjistruar Maliku në librin e tij “Muveta’ë”: **“Nëna e djalit Zejd bin Erkam, i ka thënë Aishes r.a.: - Oj nëna e besimtarëve, unë jam shitur prej Zejd bin Erkamit me çmimin prej tetëqind dërrhemëve me para të gatshme, pastaj jam blerë prej tij me çmim prej gjashtëqind dërrhemëve.**

Aishja r.a. i thotë – Mjerë për të çka ka shitur dhe mjerë për të çka ka blerë. Lajmëroje Zejd bin Erkamin se ai e ka humbur vlerën e xhihadit të tij me pejgamberin s.a.v.s. deri sa të pendohet.

Ai i thotë: - Çka mendon sikur ta merrja profitin e asaj tregtie.

Aishja i përgjigjet duke ia lexuar ajetin kur’anor:

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ الرِّبَا ۚ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۚ فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّهِ فَانْتَهَىٰ فَلَهُ مَا سَلَفَ وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ ۚ وَمَنْ عَادَ فَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

“Ata që e hanë kamatën nuk ngrehen ndryshe pos siç ngrehet i çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bëjnë) kështu ngase thanë: “Shitblerja nuk është pos kamatë!” e All-llahu ka lejuar shitblerjen, ndërsa ka ndaluar kamatën. Atij që i ka ardhur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalur (prej kamatës) i ka takuar e kaluara dhe çështja e saj mbetet te All-llahu, e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbesin përgjithmonë.” (El Bekare : 275)⁶¹

Kjo formë e shitblerjes është formë për të cilën ka divergjenca:

Karafiu thotë:⁶² Kjo me të vërtetë është çështje shumë serioze dhe Aishja r.a. nuk thotë tjetër përpos largimit nga kjo shitblerje dhe largimi nga kjo është obligim.

Autori i librit “Mukadimat” Ibn Rushdi thotë: Kjo shitblerje e nënës së djalit të Zejd bin Erkamit dhe zotërisë së saj ka qenë para lirimit (nga robëria). Dhe thënia e Ajshes r.a. nuk bën pjesë në ndalimin e kamatës në mes të zotëriut dhe robit me thënien për ndalimin e këtij preteksti. Ndoshta Zejdi nuk ka menduar për ndalimin e kamatës e cila bëhet në mes të zotëriut dhe robit të tij.⁶³

Argumentet e Shafiijve

Zerkashiu dhe disa dijetarë Shafiijë, i janë përgjigjur argumentit të Malikijve, me atë se Aishja r.a. e ka thënë këtë në bazë të ixhtihadit të saj, ndërsa është aprovuar me ixhmaë se ixhtihadi i njërit prej sahabëve nuk është argument për sahabiun tjetër, përpos kësaj, thënia e saj bie ndesh me veprimin e Zejd bin Erkamit, pastaj ajo nuk e ka pranuar këtë shitblerje për shkak të prishjes së shitblerjes sepse nuk është përcaktuar shitblerja për arsye se:

- **shitblerja e parë** është e pavlefshme se nuk është përcaktuar afati sepse momenti i dorëzimit ka qenë i panjohur.

- **shitblerja e dytë** është bërë mbi shitblerjen e parë, për këtë arsye është e pavlefshme.⁶⁴

Pastaj duke i bazuar pretendimet e tyre, Shafiijtë prej argumenteve të Malikijve kalojnë në argumente tjera dhe thonë: Siç u përmend, nëse sahabët kundërshtohen në mes vete atëherë ne e kemi argumentin e kijasit dhe argumentin me tri çështje:

E para: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا إِنَّمَا الْبَيْعُ مِثْلُ الرِّبَا ۚ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا ۚ فَمَنْ جَاءَهُ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّهِ فَانْتَهَىٰ فَلَهُ مَا سَلَفَ وَأَمْرُهُ إِلَى اللَّهِ ۖ وَمَنْ عَادَ فَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

“Ata që e hanë kamatën nuk ngrehen ndryshe pos siç ngrehet i çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bëjnë) kështu ngase thanë: “Shitblerja nuk është pos kamatë!” e All-llahu ka lejuar shitblerjen, ndërsa ka ndaluar kamatën. Atij që i ka ardhur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalur (prej kamatës) i ka takuar e kaluara dhe çështja e saj mbetet te All-llahu, e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbesin përgjithmonë.” (El Bekare : 275)

Karafiu u përgjigjet⁶⁵ atyre me atë se ky tekst është i përgjithshëm, përderisa hadithi është specifik. **Ligji Specifik ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm** ashtu siç dihet në shkencën e usulit.

E dyta: Është vërtetuar në sunet se: **“I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka ardhur me hurmën e llojit “xhenib” dhe ka thënë: - A janë të gjitha hurmat e Hajberit kështu?**

I janë përgjigjur: - Ne e bëjmë shitblerjen një saae me dy saa prej hurmave tjera.

Muhamedi s.a.v.s. u thotë: - Mos veproni ashtu, por shitni hurmat tjera me dërhëm dhe pastaj me dërhëm blini hurmat e llojit xhenib.”⁶⁶

Kjo shitblerje është një saa me dy saa por vetëm se në ndërmjetësimin e tyre ka ndërhyrë akti i dërhemëve dhe është lejuar.

Karafiu pastaj thotë: Malikijtë e ndalojnë aktin e dytë të shitblerjes nga shitësi i parë, mirëpo kjo nuk është bërë e njohur me hadith edhe pse shitblerja me tëholla kur bëhet këmbimi atëherë humb shansi për t’u akuzuar, por ndalesa është se akuzimi bëhet më i fuqishëm.

E treta: Akti i cili shpie në zhvlerësim nuk është i pavlefshëm nëse i plotëson kushtet themelore të saj, si f.v., shitja e shpatës atij i cili i bllokoi rrugët, rrushin për prodhuesin e alkoolit, edhe pse shkatërrimi në bllokimin e rrugës është më serioz se shpata e cila sjell dobi, pasi që me të shuhet jetët e njerëzve dhe humbet pasuria.

Karafiu thotë se boshti i kësaj teme është në rastin kur nuk ka qëllime të këqija të cilat shpijnë deri te ajo kontratë, përndryshe pengohet sikurse në aktet kur ka divergjenca. Ka dallim në mes të këtyre shitblerjeve dhe shitjes së shpatës (armëve) kriminelëve, e të ngjashme, sepse shitja për kriminelët nuk shpie në ndërprerjen e rrugës dhe në veprimtarinë e alkoolit sepse dëmi nuk është i varur vetëm prej blerjes ashtu që ajo të ndikojë në akt si te format e mospajtimeve.

Sa i përket temës për të cilën nuk janë pajtuar, unë mendoj se: Është e lejuar ajo e cila merret si pretekst për dëmtim sepse duhet të mbyllet shtegu para mashtguesve, shkatërruesve, të cilët angazhohen t’i shkëpusin lidhjet e sheriatit dhe dispozitat e saj. Sheriati ka ardhur për të realizuar interesat dhe për të ndaluar dëmet. Në të vërtetë shikohet në pretendimet dhe qëllimet e çështjeve. Nëse ato objektiva janë të dëmshme, ndalohen prej shkaqeve që i realizojnë ato objektiva, mbyllen mjetet dhe rrugët me të cilat arrihet deri te ato objektiva edhe nëse ato mjete në vetvete janë të lejuara.

Të këtij drejtimi janë Malikijët dhe Hanbelijët, pastaj afër tyre në këtë çështje janë Hanefijët sepse janë më produktiv dhe në të vepruar janë më kategorik dhe ndalimi i masave të dëmshme (jo ligjore) janë shkak për t'i akuzuar – pra kjo do të thotë: Gjykohen për shkak se në mendje kanë pasur për qëllim të arrijnë te e ndaluara.

Imam Shafiiu këto shitblerje nuk i ndalon, për shkak të dy parimeve. Gjithmonë duhet gjykuar për të jashtmen, akti nuk zhvlerësohet vetëm se i bashkëngjitet diçka dhe nuk zhvlerësohet me diçka e cila e përshpejton ose e vonon, as me ndjenjë imagjinare, as për shkak se ndodh në të shumtën e rasteve.⁶⁷

Për rastet tjera, përpos shitblerjeve kamatare, dijetarët janë pajtuar se duhet vepruar me bazën parandaluese edhe pse disa prej tyre nuk e cilësojnë me këtë emërtim, por ata nuk pajtohen për nivelin e dëmit dhe mënyrën sqaruese deri te arritja e dispozitës.

Më së shumti që veprojnë me këtë janë dy imamët: Maliku dhe Ahmedi, pason Ebu Hanife, ndërsa më së paku vepron imam Shafiiu r.a. Ai pajtohet me atë çka është transmetuar prej Shafiiut për ndalimin e mishit të kalit, mirëpo këta dy imamë nuk e konsiderojnë si bazë e pavarur ligjore por e llogarisin brenda bazave ligjore të konfirmuara prej tyre siç janë: Kijasi, istis'hani i fshehtë, i cili nuk është larg mendimit të Shafiiut, përpos traditës e cila bëhet traditë në mesin e njerëzve.

Nuk duhet të hiperbolizohet me të cilësuarit të veprimeve me masat ligjore sepse ai i cili zhytet thellë në të ndonjëherë mund të ndaloj çështjen e lejuar ose që është e pëlqyeshme ose që është obliguese, e kjo nga frika se mos po bien në veprim të padrejtë, si f.v., kur disa nuk pranojnë të marrin përgjegjësinë e perkujdesjes së jetimëve dhe menaxhimin e pasurisë së tyre ose përgjegjësinë për mbikëqyrje të vakëfeve nga frika se mos akuzohen prej njerëzve ose nga frika se mos bëjnë padrejtësi sepse është vërejtur se disa njerëz privohen nga shumë çështje nga frika se mos po veprojnë haram.⁶⁸

Gjeneza e mospajtimimit në mes të dijetarëve

Divergjenca në masat ligjore, ashtu siç kanë ndodhur në një rreth të ngushtë siç janë: rasti i shitblerjes “AXHAL” dhe në rastet kur nuk mund të zbulohet qëllimi i kontraktuesve dhe që nuk tregohet për qëllim të veprimit me kamatë në të, argumentet e përsëritjes së saj e të ngjashme.

Karafiu thotë:⁶⁹ Kush e shet një artikull me çmim të dhjetë derhemëve për një muaj, pastaj e blenë për pesë derhem para një muaji, Maliku (me të Ahmedi) thotë: ai i ka nxjerrë prej dore pesë derhem, pastaj i ka marrë dhjetë derhem deri në fund të muajit. Kjo është mënyrë e SELEF-IT: pesë për dhjetë, deri në afat të caktuar duke e paraqitur si formë e shitblerjes, për këtë Shafiiu shikon në formën e shitblerjes dhe shikohet çështja në anën e jashtme ku sipas saj lejohet dhe për këto lloje të shitblerjeve thuhet se arrijnë në njëmijë raste (çështje për të cilat veçohet Maliku dhe së bashku me të Ahmedi, ndërsa e kundërshton Shafiiu). Çka ndikon në mospajtimin e tyre?

Shkakun e mospajtimimit të tyre duhet shikuar në çështjen shumë të rëndësishme të shariatit islam e ajo çështje është: **“Shprehjet dhe qëllimet në kontrata.”** Në këtë çështje fikhu islam është orientuar në dy drejtime.

Drejtimi i parë: Drejtimi Shafiië, i afërt me të medhhebi Hanefijë: Në kontrata merren për bazë shprehjet dhe jo nijetet dhe qëllimet sepse nijeti dhe qëllimi i cili nuk është i lejuar ligjërisht është i fshehtë dhe kjo çështje i lihet vetëm Allahut, për atë qëllim do të dënohet, për këtë arsye kanë deklaruar se: **“Në urdhrat e Allahut merret parasysh kuptimi, ndërsa në çështjet e njerëzve emërtimi dhe shprehja.”** Që do të thotë se në ato çështje të cilat në kontratë nuk tregohet qartë nijeti apo faktet të cilat e tregojnë nijetin, veprohet me rregullin **“Merren për bazë kuptimet e jo konstrukti dhe shprehjet.”**⁷⁰ Dhe kështu, te Shafiijtë çdo kontrate i shikohet konstrukti dhe faktet rreth konstruktit të fjalës që të dispozitohet. Shpallet e pavlefshme nga konstrukti i saj dhe llogaritet e vlefshme po ashtu prej konstruktit të saj dhe nuk mund ta zhvlerësojnë çështjet jashtë saj edhe nëse ka nijete dhe shenja të qëllimit jashtë formulimit të kontratës ose edhe pse ka pikësynime dhe nijete të cilat vërtetohen prej kontraktuesve.

Drejtimi i dytë: Drejtimi Hanbelijë, i cili është më rigoroz në vështirimin e nijetit dhe qëllimit dhe nuk e shikon tekstin e kontratës (fjalën në tekst). Medhhebi i tij merr formën përfundimtare nga kuptimi i thënies së Ibni Kajimit, të cilën do ta sqarojmë si në vijim.⁷¹

a. Nëse teksti përputhet me qëllimin, atëherë në bazë të saj rezultojnë aktet juridike (sheriative).

b. Nëse qëllimi është i kundërt me atë që e tregojnë shprehjet në kontratë, atëherë i merret nijeti vetëm fetarisht, pra për në botën tjetër, pra përgjegjësinë para Allahut, vetëm se dispozita merret në bazë të shprehjeve (jo në bazë të qëllimit).

c. Nëse zbulohet ndonjë dëshmi e qëllimit dhe e cila nuk është në kundërshtim me sheriatin, kontrata është e vlefshme, po të jetë ndryshe kontrata zhvlerësohet dhe nuk rezulton asgjë.

Drejtimi i parë: Shqyrtimi i dispozitës ku shihet qartazi dhe shihen qartazi rezultatet pasi që të realizohet (kontrata), pa i shikuar qëllimet dhe apetitet. Imam Shafiiu vepron me argumentin e masës parandaluese, gjithashtu ai e ka zgjeruar që të shikohen në përgjithësi në aspektin material në të gjitha anët e shariatit dhe këtë rregull e praktikon në kontrata dhe në raportet ndërnjerëzore.⁷²

Këtë formë të shqyrtimit – e kanë kundërshtuar dy imamët Maliku dhe Ahmedi për ta dispozituar si masë parandaluese, këta dy i shqyrtojnë vetëm apetitet dhe qëllimet dhe gjithashtu shqyrtojnë çka ndikon deri aty. Kush lidh kontratë dhe ka për qëllim të veproj ndonjë haram dhe e keqpërdor aktin, atëherë edhe fitimi (prej asaj kontrate) edhe rrugët që shpijnë te realizimi, e bëjnë që kontrata të jetë haram (e ndaluar) dhe bën mëkat te Allahu dhe akti shpallet i pavlefshëm sepse është kontratë kamate. Ndalesa bëhet për të penguar qëllimin e keq.

Unë e shoh të patjetërsueshme që ta pranoj (zgjedh) drejtimin e Malikut dhe Ahmedit r.a. sepse përkon me rregullin “Veprat shpërblehen sipas qëllimit.” dhe hadithi **“Pa dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit dhe nuk ka dyshim se çdo njeri shpërblehet për atë që e ka pasur për qëllim.”** Në pjesën e parë Muhamedi s.a.v.s. ka sqaruar se vepra realizohet vetëm me nijet, ndërsa në pjesën e dytë të hadithit ka sqaruar se vepruesi nuk ka asgjë tjetër prej veprës së tij, pos atë që e ka pasur për qëllim. Kjo përfshinë të gjitha veprat si në adhurime, veprimtaritë ndërnjerëzore, përbetime, betime dhe në të gjitha kontratat dhe manifestimet e veprave të

njeriut.⁷³ Ky është argument se kush e ka për qëllim që me shitblerje të lidhë kontratë kamatare, ajo formë e shitblerjes nuk mund ta mbrojë nga ndalesa e haramit.

Përpos kësaj, ky orientim është më afër devotshmërisë dhe më afër objektivave të sheriatit, i cili ka ardhur ta organizoj jetën e njerëzve mbi bazat e shëndosha dhe të dobishme dhe që shoqëria të jetojë sa më mirë dhe të krijoj sistem të shëndoshë shoqëror, ekonomik dhe politik.⁷⁴

Triumfi i Ibni Kajimit me parimin e realizuesit apo “qëllimin e aktit”

Siç treguam, Ibn Kajimi ka folur gjerë e gjatë në sjelljen e argumenteve të shumta për të konfirmuar parimin e **“ndalimit të veprimeve që shpijnë te e paligjshmja.”** Ai e shpjegon: Personi i cili formulon tekstin e kontratës, nëse e ka atë qëllim, atëherë rezultojnë dispozitat për të drejtat dhe përgjegjësitë e tij. Nëse nuk e ka atë qëllim:

- ose ka për qëllim të kundërtën e tekstit;
- ose nuk e ka pasur atë qëllim,
- ose qëllim tjetër të kuptimit të saj.⁷⁵

Nëse nuk e ka pasur qëllim atë që e thotë do të thotë se ai është tallur.

Nëse ka pasur qëllim tjetër, atëherë:

- ose ka pasur qëllim që lejohet,
- ose që nuk lejohet,

Nëse ka pasur për qëllim atë çka e lejon qëllimin e tij dhe nuk e tregon dispozita e aktit atë që është në formulim të tekstit, dispozitat e atyre formulimeve të aktit nuk rezultojnë asgjë në mes tij dhe Allahut të Lartmadhëruar, përderisa sa i përket kësaj bote, nëse dyshohet me ndonjë fakt se e ka atë qëllim po ashtu nuk mban përgjegjësi sepse kontesti edhe faktet tregojnë për sinqeritetin e tij dhe nëse fjalës së tij nuk i bashkëngjitet ndonjë fakt dhe kësaj vetëm i paragjykohe paragjykime, nuk i pranohen ato gjykime.

Nëse ka pasur qëllim diçka që nuk lejohet si f.v., fjala e personit “u martova, e lidha kontratën e martesës”, por për t’u martuar (për ta

shkurorëzuar) apo që pastaj t'i lejohet treshkurorëzuesit të saj të mëhershëm ose blenë e shet me qëllim kamate, e të ngjashme, dhe kjo nuk e realizon qëllimin të cilin ka dashur ta realizoj dhe fjalën e jashtme dhe veprimin e jashtëm e bën mjet për ta realizuar atë, atëherë realizimi i qëllimit është zbatim i haramit dhe ikje nga obligueshmëria dhe mbështetje e mëkatit ndaj Allahut dhe kundër fesë dhe sheriatit të Tij. Kështu, mbështetja në të është mbështetje në mëkat dhe armiqësi.

Nuk ka dallim në mes të mëkatimit dhe shprehjes haptazi të saj dhe në mes të mbështetjes së saj nëpërmjet rrugës të cilën e trason për të arritur te tjetri i cili pastaj e merr si metodë për te harami, si f.v., ai i cili lidhë kontratë shitblerje që ajo kontratë të jetë rrugë për te kamata. Kështu pra, qëllimi është i njëjtë.

Nuk ka dallim në mes të rrugëve të cilat shpijnë deri te dispozita me ndryshimin e dispozitës së atij veprimi dhe ndalohej prej rrugës së saj dhe po e njëjta lejohet nga një rrugë tjetër.

Rrugët janë mjete dhe me to pikësynohet për çështje tjera dhe çdo dallim në mes të arritjes te harami nëpërmjet mashtrimit, lajkatimit dhe tradhtisë, dhe arritjes deri aty nëpërmjet rrugëve të hapëta të cilat janë në përputhshmëri të cilat mbahen sekrete nga publiku.

Qëllimi i shprehjes i cili është orientim i këtyre rrugëve, ndonjëherë përfundimin e ka më të mirë dhe rreziku i saj është më i vogël nga shumë aspekte se sa të trasonte rrugën e tradhtisë dhe lajkatimit të njerëzve i cili është mëkat sepse në zemrat e tyre krijohet përshtypja e cila është më e keqe se sa të veprohet në mënyrë të drejtpërdrejt.

Pastaj, në një vend tjetër Ibni Kajimi sqaron rastin⁷⁶ kur fjalës i jepet kuptimi i jashtëm dhe thotë: Dispozitat e sheriatit shikohen nga ana e tyre e jashtme, në atë që dihet prej njerëzve kuptimi i fjalës nga qëllimi i folësit ose që nuk e shpalos qëllimin i cili është në kundërshtim me fjalën e tij. Përderisa nijetet dhe qëllimet llogariten në atë çka e thotë haptazi e cila është ndryshe nga teksti dhe shprehja.

Fjalimin e tij të gjatë Ibn Kajimi e përfundon me rregullin e sheriatit: **Në sheriatë merret për bazë qëllimi dhe nijeti dhe jo vetëm shprehja** sepse formulimi i akteve tregon çka ka në zemër prej kuptimit të cilin e ka dashur Ligjvënësi.

Ibn Hazmi dhe masat parandaluese

Ibn Hazmi e mohon bazën e masave parandaluese sepse është temë prej temave të ixhtihadit me logjikë. Ai është kundër çdo vendimi në bazë të paramendimit. Në faqet e para të volumit të gjashtë të librit të tij **“El ihkam”**⁷⁷ Ibn Hazmi i ka kushtuar vëmendje të veçantë kësaj teme duke replikuar me ata të cilët pranojnë masat parandaluese si ligj rezervë. Në mes tjerash ai thotë: Disa shkojnë në drejtim të ndalimit të çështjeve prej rrugëve rezervë nga frika se mos po bien në haram klasik, ata janë argumentuar me hadithin e Nuëman bin Beshirit i cili ka thënë: Kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: **“Hallalli është i sqaruar, harami është sqaruar, dhe në mes tyre ka gjëra të dyshimta, të cilat nuk i dinë shumica e njerëzve. Kush largohet nga gjërat e dyshimta, ai e ka siguruar fenë dhe nderin e tij dhe kush vepron të dyshimtat ai ka vepruar çështje të haramit, sikurse njeriu i cili qëndron buzë greminës dhe në çdo çast mendon se do të bie në të, dhe çdo pronë e ka kufirin ndërsa kufijtë e Allahut janë ndalesat e tij.”** (Mutefikun alejhi në mes të Buhariut dhe Muslimit)

Nga kjo kuptohet se Ibni Hazmi e ka përkufizuar çështjen e masave parandaluese në të larguarit prej çështjeve të dyshimta si rezervë, mirëpo ata të cilët e pranojnë e parashohin të përfshihen tri çështje:

E para: Largimi nga vendet e dyshimta. Ky është minimumi dhe kërkesa e saj nuk është në fuqinë e kërkesave tjera.

E dyta: Largimi nga çdo gjë që shpie në haram, si shitja e armëve në kohë ngatërresash.

Këto dy çështje bëjnë pjesë nën konceptin *masat parandaluese*.

E treta: Masa lehtësuese, e cila në mënyrë absolute shpie te realizimi i qëllimit si f.v., angazhimi për namaz, angazhimi për furnizim për të shpenzuar për familjen.⁷⁸

Te Ibn Hazmi hadithi nuk është për ligjin obligativ sepse nuk ka ndalesë përpos me argument të prerë, mirëpo është vetëm për nxitje devotshmërie dhe siguri për fenë dhe veten, që të mos shkaktohen të ndaluarat dhe kjo nuk është obligimi. Devotshmëria shpie edhe në të ndaluarit nga disa çështje të lejuara, për ta mbrojtur veten nga dëshirat e tepërta të epshit.⁷⁹

Në këtë pikë Ibn Hazmi takohet me imam Shafiiun sepse vendimet për ndalesa dhe lejime merren në bazë të presupozimeve. Kush i ndalon masat shfrytëzuese ai ka ndaluar me paragjykim e Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا يَتَّبِعْ أَكْثَرُهُمْ إِلَّا ظَنًّا ۚ إِنَّ الظَّنَّ لَا يُغْنِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا ۚ إِنَّ اللَّهَ
عَلِيمٌ بِمَا يَفْعَلُونَ

“Shumica e tyre nuk kërkojnë tjetër pos supozim, e supozimi nuk është asgjë ndaj të vërtetës. All-llahu di shumë mirë për atë që punojnë.” (Junus : 36)⁸⁰

E vërteta është se Ibn Hazmi nuk i pranon masat shfrytëzuese, duke shkuar me parimin e tij, e ai parim është **“të vepruarit vetëm me kuptimin e jashtëm të fjalës, duke mos shikuar në tekstin i cili pikësnohet prej saj”**, e ai është fanatik në këtë parim dhe kjo ka ndikuar që të mohoj atë për të cilën janë pajtuar dijetarët, për llogaritjen apo mosllogaritjen e tij, siç shihet qartë në lejin e dëshmisë së prindërve, fëmijëve, bashkëshortëve dhe shokëve për njëri-tjetrin përderisa të jenë të drejtë sepse akuzimi për këto dëshmi është paragjykim ndërsa drejtësia e tyre është e vërtetuar.⁸¹

Replikimi i mendimeve të Ibni Hazmit

Në mendimet e Ibni Hazmit ka të meta sepse masat e paligjshme i ka përkufizuar në ato çështje të cilat i kemi përmendur e ajo është **“nëse diçka është e dyshimtë nuk është haram”**.

Në lidhje me këtë ka deklaruar atë që e përfshinë hadithi i Nuëman bin Beshirit: **“Hallalli është i sqaruar, harami është i sqaruar dhe në mes tyre ekzistojnë çështje të dyshimta...”** nuk është dispozitë ligjore obligative sepse nuk ndalohet diçka vetëm nëse për atë çështje ekziston tekst i prerë për ndalesën e tij sepse argumentet e hallallit janë të ligjësuara me argument të sigurt siç është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ ۚ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Ai (All-llahu) është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë, pastaj vullnetin e Vet ia drejtoi qiellit dhe i bëri ata shtatë qiej. Ai është i Gjithëdijshmi për çdo gjë.” (El-Bekare : 29)

dhe thënia tjetër:

قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ لَكُمْ مِّن رِّزْقٍ فَجَعَلْتُم مِّنْهُ حَرَامًا وَحَلَالًا قُلْ اللَّهُ أَذِنَ لَكُمْ ۚ أَمْ عَلَى اللَّهِ تَفْتَرُونَ

“Thuaj: Më thoni, atë që All-llahu ju dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar? Thuaj: A ju lejoi All-llahu ju, ose ju i shpifni All-llahut?” (Junus : 59)

Zoti i Lartmadhëruar nuk ka lejuar që e dyshimta të jetë ndalesë e prerë dhe nuk mbetet pos që të thuhet se **“Esenciale është që prej teksteve buron ligjësimi i lejimit (të çështjeve) dhe i pëlqimit (të çështjeve)”**.

Mirëpo si vepron Ibn Hazmi me hadithin i cili nuk ka për qëllim ndalimin e të dyshimtës?

Ai thotë: Hadithi tregon për nxitje në devotshmëri dhe sigurimin e fesë dhe vetes ashtu që të mos bihet pre e haremeve. Kjo nuk është prej ligjësimëve por kërkesë për devotshmëri, ndërsa modestia ndonjëherë e kërkon edhe largimin nga disa gjëra të lejuara, për ta mbrojtur veten nga çdo

kënaqësi e epshit, e ai thotë:⁸² Kjo është nxitje nga Muhamedi a.s. për t'u bërë i devotshëm dhe ka thënë haptas se: **ajo çka është buzë greminës nuk është brenda greminës dhe se ato gjëra të dyshimta nuk janë ndalesa të sigurt dhe përderisa nuk janë klasifikuar si ndalesa, atëherë dispozitimi i tyre është *hallalli*, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:**

وَمَا لَكُمْ أَلَّا تَأْكُلُوا مِمَّا ذُكِرَ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَقَدْ فَصَّلَ لَكُمْ مَا حَرَّمَ عَلَيْكُمْ
إِلَّا مَا اضْطُرَرْتُمْ إِلَيْهِ ۚ وَإِنَّ كَثِيرًا لِّيُضِلُّونَ بِأَهْوَائِهِمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۚ إِنَّ رَبَّكَ
هُوَ أَعْلَمُ بِالْمُعْتَدِينَ

“Ç’keni ju që të mos hani nga ajo për të cilën është përmendur emri i All-llahut, e Ai ju sqaroi juve se çka është ndaluar për ju, përveç kur jeni detyruar (atëherë edhe harami është hallall). Një shumicë (e mohuesve), duke mos pasur kurrfarë dije, por vetëm nga pasionet e tyre, duan t’i largojnë nga e vërteta (njerëzit). Po Zoti yt di më së miri për ata që i shkelin dispozitat.” (El-En’am : 119)

Dhe ajo çka nuk është sqaruar ajo është hallall në bazë të thënies së Muhamedit a.s.: **“Në islam, mëkati më i madh i njeriut është atëherë kur pyetet për diçka që nuk është haram, por e bënë haram për shkak të pyetësit.”**⁸³

Hadithi kërkon që të largohemi nga gjërat e dyshimta, e kjo është nxitje për devotshmëri. Ibn Hazmi e bën ndarjen në mes të obligueshmërisë dhe nxitjes për devotshmëri:

- obligueshmëria nuk ka të bëjë me ndalimin kategorik, ndërsa,
- nxitja ka të bëjë me kërkesën se prej çka duhet larguar dhe çka duhet vepruar.

Në lidhje me këtë transmeton thënien e pejgamberit s.a.v.s.: **“Nuk mund të arrijë njeriu nivelin e devotshmërisë deri sa nuk e lë atë çka nuk është e nevojshme, për shkak të asaj që është e nevojshme.”**⁸⁴ Pastaj vazhdon dhe thotë se, mesazhi prej këtij hadithi është i njëjtë me mesazhin e hadithit të Nuëmanit e ai është: për nxitje devotshmërie dhe jo për obligueshmëri.⁸⁵

Dhe për këtë arsye, Ibn Hazmi nuk e ndalon ndonjë veprim, nga kujdesi se mos po bën ndonjë veprim tjetër i cili shpie në haram, mirëpo nëse është e sigurt se është haram dhe nuk dihet konkretisht, atëherë ndalimi bëhet për shkak se dihet saktësisht. Në lidhje me këtë e sjell një shembull:

Dy ujëra në dy enë.

Në njërën enë dihet saktësisht se është i pastër.

Në enën tjetër dihet saktësisht se është i papastër mirëpo, nuk dihet se cila prej tyre është e papastër dhe cila prej tyre është e pastër.

Në këtë rast nuk lejohet të merret abdes në asnjërën prej tyre sepse ai ka marrë abdes saktësisht prej enës së papastër.⁸⁶

Për këtë arsye thotë: Çdo veprim i cili ia bën me dije vepruesit se saktësisht është duke bërë haram me atë veprim ose me atë veprimin tjetër, siç është rasti me dy ujërat në dy enët, në njërën prej tyre ekziston dyshimi në pastërti, ndërsa ekziston bindja se tjetra është e papastër, por nuk e di konkretisht se cila është e papastër dhe kur të merr abdes me ato dy enë ne jemi të sigurt se nëse ai falet është falur i papastër dhe kjo është ajo çka nuk lejohet.

Njësoj është çështja me dy palë rrobat, kur:

- Njëra palë është e sigurt se është e papastër dhe,
- Tjetra palë nuk është e sigurt se është e papastër dhe,
- Nuk dihet se cila palë është konkretisht e papastër.

Nga ajo çka u sqarua konkludohet se për atë çka nuk konfirmohet ndalesa, nuk lejohet që muftiu të jep fetva se është haram me pretendimin se vepra shpie në haram dhe po ashtu thotë se është haram për një çështje e cila është mendim jo i prerë.

Kush ndalon diçka të dyshimtë dhe jep fetva për atë çështje (se është e ndaluar) ai veç ka shtuar në fe diçka që Allahu nuk e ka lejuar dhe e ka kundërshtuar pejgamberin s.a.v.s. dhe ka kuptuar prej Zotit të tij dhe prej çështjeve të sheriatit me konceptimin e tij.

Në lidhje me gjithë këtë mjafton ixhmai i dijetarëve i cili është raportuar gjeneratë pas gjenerate se: Kush ka qenë në kohën e pejgamberit a.s. dhe në prezencën e tij në Medine se kur dikush dëshiron të blej diçka çka hahet ose vishet ose çka mbathet ose çka hipet ose çka shfrytëzohet ose çka pronësohet ose çka do qoftë ose ka hyrë në tregun e muslimanëve ose e takon një musliman duke blerë diçka dhe blenë prej tij, ai duhet të blejë çka konkretisht nuk është haram ose çka nuk dominon në haram diçka çka fshihet me hallallin. E dihet pa dyshim se në treg ka uzurpatorë, hajdutë dhe

sende të vjedhura. Të gjitha këto kanë qenë aty e këtu, ndërsa peygamberi s.a.v.s. nuk ka ndaluar diçka prej atyre shitblerjeve (në treg). E dihet se ato kanë qenë vende të dyshimta.

Po ashtu dihet rasti i beduinëve të cilët e kanë pranuar fenë islame së voni, u dhuronin mish kurbanit dhe nuk e dinin se a e kanë përmendur (gjatë therjes) Zotin apo jo? Ndërsa e kanë pyetur peygamberin s.a.v.s. se a lejohet ta pranojnë mishin e kurbanëve të tyre.

Peygamberi s.a.v.s. u është përgjigjur: **Përmendeni ju emrin e Allahut, dhe ushqehuni (me atë mish)**, ose ka thënë diçka në këtë kuptim.⁸⁷

Ekzistojnë transmetime se peygamberi s.a.v.s. ka urdhëruar që kush ushqehet me ushqimin të vëllait të tij, të ushqehet dhe të mos pyet (burimin e ushqimit).⁸⁸

Ne i nxisim njerëzit për devotshmëri ashtu siç i ka nxitur peygamberi s.a.v.s. Ne i edukojmë dhe i këshillojmë që të largohen prej gjërave të cilat krijojnë dyshime në mendje, por nuk e gjykojmë askënd, nuk japim fetva të prerë, ashtu siç peygamberi s.a.v.s. nuk e ka gjykuar askënd.⁸⁹

Dakordimi i Ibni Hazmit dhe Shafiijut

Pas kësaj kritike, Ibn Hazmi takohet me Shafiijun r.a. dhe gjykon se hallalli dhe harami nuk dispozitohen me hamendje. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا يَتَّبِعْ أَكْثَرُهُمْ إِلَّا ظَنًّا ۚ إِنَّ الظَّنَّ لَا يُغْنِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِمَا يَفْعَلُونَ

“Shumica e tyre nuk kërkojnë tjetër pos supozim, e supozimi nuk është asgjë ndaj të vërtetës. All-llahu di shumë mirë për atë që punojnë.”
(Junus : 36)

Në fund të shkrimit të tij, për rezervën dhe vendimin e prerë për masat parandaluese dhe për çështjet e dyshimta thotë: Çdo kush i cili gjykon me rezervë dhe nuk është i sigurt në çështjen e tij ose në diçka, frikësohet në masën preventive, ai veç ka gjykuar me hamendje dhe kur gjykon me hamendje ai ka gjykuar me gënjeshtër dhe padrejtësi dhe kjo nuk lejohet. Ai ka gjykuar me emocion dhe i është larguar të vërtetës. Kërkojmë mbrojtje prej çdo kujt i cili shkon në këtë drejtim në këtë çështje sepse ky drejtim në vetvete është poshtërues, i pavlefshëm dhe kundërtshëm, sepse në akuzim asnjë nuk ka përparësi ndaj tjetrit. Nëse një çështje e lejuar bëhet haram është hapur shtegu i haramit. Do të izolohehen njerëzit nga frika se mos bëjnë prostitucion, do të vriten njerëzit nga frika se mos bien në pabesim, do të shkulen vreshtat nga frika se mos prodhohet alkooli. Me një fjalë, ky është drejtimi më i çoroditur në tokë sepse shpie në devalvimin dhe shkatërrimin e të gjitha realiteteve. Zotit të Lartmadhëruar i kërkojmë pajtueshmëri.⁹⁰

Vërejtjet ndaj mendimit të Ibni Hazmit

Pas analizës së gjithë asaj që ka thënë Ibn Hazmi vërejmë si në vijim:⁹¹

1. **Dyshuesi i cili dyshon për një çështje a është haram apo hallall.** Ai i cili qëndron buzë greminës, ekziston frika se mund të bie në të. Pa dyshim se nuk duhet të llogaritet haram në formë të prerë.

Këtë (se është haram) nuk e ka thënë askush prej muslimanëve. Ajo për të cilën dyshohet se është e ndaluar sikurse e ndaluara në formë të prerë nëse ekziston për të tekst i qartë. Ata të cilët kanë dhënë fetva se janë të ndaluara disa çështje të dyshimta, nuk kanë thënë se janë të ndaluara në formë të prerë por kanë thënë se është rezervë në fe.

2. **Gjykimi për një çështje se është haram, bëhet në bazë të animit të gjykimit dhe natyrshmërisë se në të shumtën e rasteve shpie deri aty, ndërsa në rastet e rralla nuk shpie në haram.** Për këtë arsye nuk është e drejtë të thuhet: Në bazë të këtij paragjykimi duhet të tridhen burrat që të mos bëjnë prostitucion; të ekzekutohen njerëzit që të mos shkaktojnë trazira; të ndalohet mbjellja e plantacioneve të rrushit që të mos prodhohet alkooli, etj., sepse kjo nuk ndodh, me fjalë tjera nuk mund të analogohet për të parandaluar rrugën e keqe sepse shumica e njerëzve nuk bëjnë prostitucion dhe në të shumtën e rasteve nuk prodhohet alkooli prej rrushit, etj.

Pas kësaj, mbi atë çka u tha më lartë, Zoti i Lartmadhëruar ka ndaluar për mortalitet dhe ka nxit për natalitet:

- ka urdhëruar njerëzit të mos vriten në mes vete;
- ka ndaluar keqpërdorimin e pasurisë së njëri-tjetrit;
- ka ndaluar vet-izolim;
- ka ndaluar asgjësimin e vreshtave të rrushit, etj.

Të gjitha këto janë të ndaluara me tekste ligjore. Nuk është e drejtë që të lejohet e ndaluara me pretendimin se është masë parandaluese pasi që Allahu veç i ka ndaluar, me fjalë tjera ato janë të ndaluara me tekste ligjore.

Nuk lejohet të jenë të ndaluara për shkak se prej saj mund të bëhet e ndaluar çështja tjetër sepse e ndaluara në vetvete e ka anën prioritare prej asaj që shpie në të.

Askush nuk duhet ta sulmoj tjetrin nga frika se ai e sulmon tjetër kënd sepse ai është i siguar po aq sa është i siguar tjetri.

Nuk lejohet të bëhet padrejtësi absolute nga frika se mund të ndodhë padrejtësi e prituri.

3. Ata të cilët i pranojnë masat ligjore parandaluese dhe masat ligjore stimuluese, kanë shikuar çështjet të cilat për objektiv kanë mëkatin, si f.v:

- e shfrytëzon shitblerjen si rrugë për kamatë,
- ose e shfrytëzon kurorëzimin e përkohshëm si rrugë për t'iu mundësuar asaj gruaje martesë me burrin e mëparshëm i cili e ka shkurorëzuar tri herë,
- ose sikurse ai i cili dhuron pasuri gjatë sëmundjes në shtratin e vdekjes që t'i pengoj trashëgimtarët nga trashëgimia e tyre ligjore, ai i cili bie ndesh me sqarimet e Kur'anit.

Kush pikësynon këto çështje, që ta shkatërroj atë çka e ka ligjësuar Ligjvënësi dhe i kundërshton vendimet e sheriatit dhe i lejon të ndaluarat, qëllimi i tij do t'i rikthehet mbi të. Për këtë arsye kanë thënë: Përdorimi i këtyre masave është i ndaluar dhe veprimtaritë të cilat ka pasur për qëllim janë të pavlefshme.

Qëllimi me masat ligjore qoftë ndaluese qoftë stimuluese janë garantim i çështjeve të cilat i ka urdhëruar Ligjvënësi ose i ka ndaluar dhe nuk janë ligje shtesë nga Ligjvënësi, siç mendon Ibn Hazmi.

Sa i përket masave ligjore, dijetarët i marrin për bazë dy çështje:

E para: Qëllimi i njeriut që t'i shmanget një urdhri ligjor, si f.v., me mendua diçka se si t'i shmanget obligimit të zekatit, si f.v., t'ia dhuroj të varfrit e që pastaj ai t'ia kthej atë dhuratë ose t'i shes diçka e brenda kontratës së shitblerjes ta blej prej atij të varfri. Kjo është e ndaluar sepse është masë e sigurt për të zhvleftësuar atë që e ka urdhëruar Allahu.

E dyta: Në të shumtën e rasteve mund të jetë një çështje prej çështjeve, në një kohë prej kohëve dhe çka e ka ndaluar Allahu dhe ajo çështje është e ndaluar vetëm në atë kohë dhe jo në kohë tjera, si f.v, shitja e armëve në kohë trazirash.

Ibn Hazmi i ka kritikuar të gjithë dijetarët pse nuk e pranojnë dëshminë e prindërve (gjyshërve) për fëmijët (nipërit, mbesat) e tyre ose anasjelltas, fëmijët për prindërit e tyre me prejudikimin se mund të gënjejnë dhe gjykohet se kanë të drejtë të dëshmojnë përderisa janë të drejtë si individë sepse akuzimi (për padrejtësinë e tyre) është vetëm paragjykim ndërsa drejtësia është e sigurt dhe **e sigurta ka përparësi ndaj jo të sigurtës.**

Replikohet me atë se akuzimi i plotë ndikon në drejtësinë e tyre sepse kjo dëshmi llogaritet dëshmi për vetveten, përpos kësaj kjo është nxjerrje

nga esenca e çështjes sepse mund të shpie në argument të prerë për shkak se dëshmon dhe ka mëshirë (ndaj prindërve dhe anasjelltas) dhe që pastaj fiton hidhërimin e Allahut nëse dëshmon me padrejtësi.

Faktorët të cilët kanë ndikuar që Ibn Hazmi të mos i pranoj masat ligjore

E vërteta është se Ibn Hazmi këtë argument të cilin e llogarit si degë e gjykimit mendor e shpallë të pavlefshëm për tri arsye:

E para: Të vepruarit me çështjen e jashtme të fjalëve dhe të moslejuarit lejon që të kalohet në diçka tjetër sepse ai argumentohet në atë çka kuptohet nga natyrshmëria e fjalës dhe jo në diçka tjetër pos saj.

E dyta: Ai nuk orientohet në kuptimet sheriative, por vetëm në bazën e saj esenciale, ai nuk shikon në qëllimet e saj, bile nuk obligon qëllime fare pos obligueshmërinë, përderisa sa na përket neve, neve na intereson që të hulumtojmë arsyen apo urtësinë e kryerjes së obligimit.

Te ai, ky veprim do të ishte tejkalim i kufijve dhe të pranuarit e çështjeve me joseriozitet.

Tek ai nuk ka dallim në mes të tekstit specifik në adhurime dhe tekstit i cili ka të bëjë me raportet ndërnjerëzore. Që të dyja janë obligime dhe janë të barabarta në ligjësim.

E treta: Fanatizmi i tepërt vetëm në të jashtmen (sipërfaqësoren), sa që fanatizmi i tij ka arritur deri edhe në nivelin e përfshirjes së plotë të tij në kundërshtim me fjalën e tij. Pa dyshim se kjo është e metë në shkollën (drejtimin) e tij.

Nga kjo konkludohet se Ibn Hazmi e refuzon kategorikisht të gjykuarit e përdorimit të masave edhe poqëse themelohet ixhmai për ta marrë si bazë të argumentimit ose për ta anuluar atë, siç e pamë në lejin e dëshmisë së prindërve për fëmijët dhe anasjelltas, si dhe dëshminë e bashkëshortëve se mund të dëshmojnë në dobi të tyre dhe për shkak të mendimit të tij për hamendësinë.

Lajkatimet ligjore

Dijetarët, bazën e ndalimit të masave e kategorizojnë me ndalimin e lajkatimeve ligjore. Këtë e kanë pasqyruar Ibn Tejmije dhe Ibn Kajimi. Ky i fundit ka treguar dhe ka sqaruar pse duhet shpallur të pavlefshme lajkatimet ligjore, për të cilën nuk do të shtoj shumë në këtë çështje. Për këtë arsye unë e mendoj se ai i cili dëshiron të zgjerohet në këtë temë, le të lexojë volumnin e tretë të librit “**I’elamul Mukiijnë**”.

Definicioni i lajkatimeve të ndaluara: **Lajkatimet ligjore janë dukuri që në aspekt të jashtëm janë të lejuara, por që e zhvlerësojnë dispozitën ligjore dhe në aspekt të jashtëm e shndërrojnë në një dispozitë tjetër.**⁹² Nga ky definicion kuptohet se lajkatimi është deformim i rregullave të sheriatit. Kjo është më specifike se sa masat joligjore (parandaluese).

Kemi edhe dy çështje tjera të cilat e bëjnë dallimin në mes të masave joligjore dhe të lajkatimeve.

- Te masat joligjore nuk është e patjetërsueshme që vepruesi të ketë pasur qëllim.
- Te lajkatimi vepruesi patjetër duhet pasur qëllim që t’i shmangët haramit.
- Lajkatimi është posaçërisht për kontratat.
- Masat parandaluese janë më të përgjithshme.

Sa i përket dispozitës së lajkatimit, nëse vepruesi ka pasur për qëllim që të realizoj një haram ai veprim është haram në të kundërtën jo.

Lajkatimet janë dy llojesh:

- **Lajkatimi sheriativ i lejuar**, është lajkatimi në boshtin e rrugës legjitime e cila është bërë për një çështje konkrete dhe shfrytëzimin e saj në një rast tjetër me qëllim të:

- realizimit të së drejtës personale;
- ose të parandalimit të padrejtësisë;
- ose për të lehtësuar diçka për shkak të paraqitjes së ndonjë nevojë.

Ky lloj nuk shkakton dëmtimin e interesave të sheriatit. Kështu që kjo është e lejuar ligjërisht sepse nuk ka të bëjë me shkelje të të drejtave por për t’u nxjerrë nga kriza dhe nuk ka për qëllim bllokimin e dispozitave të sheriatit ose nuk ka pasur për qëllim për t’i bërë padrejtësi askujt, në çfarëdo aspekti qoftë fizik apo material. Shembull: Banorët e Buharës e kanë bërë zakon që të japin me koncesion tokën në periudhë afatgjate dhe pasi që

Hanefijtë nuk e lejojnë që të jepen plantacionet e pemët me koncesion, janë detyruar që të shfrytëzojnë lajkatimin duke bërë shitblerjen e “**Vefait**”. Shitblerja “**vefait**”⁹⁴ është lajkatim i sheriatit të cilën e praktikojnë njerëzit në raste nevojë dhe për të marrë fund rregulli i pengimit të koncesionit afatgjatë në agronomi.

Shembull tjetër: Njeriu i cili përbetohet se do t’i afrohet gruas gjatë muajit ramazan. Ebu Hanife jep mendim që ai njeri i cili është përbetuar duhet të udhëtoj dhe t’i afrohet gruas gjatë ditës së ramazanit.

- **Lajkatimi sheriativ i ndaluar** – siç u kuptua se me lajkatim pikësynohet shndërrimi i dispozitave të konfirmuara ligjërisht në dispozitë tjetër që të veprojnë diçka të lejuar në aspekt të jashtëm, ndërsa në aspekt të brendshëm është mashtrim. Shembull:

- Lajkatimet për të mos funksionuar shoqëria aksionare,
- ose specifikimi i disa trashëgimtarëve me testament,
- ose mosekzekutimi i dënimit të vjedhjes.

Hanefijtë dhe disa Shafijë, këto lajkatime i lejojnë, nëse nuk është qëllimi i dispozitave të qarta, por që janë mbështetje të atyre dispozitave.

Dijetarët tjerë, Maliku, Ahmedi dhe Shafiiu nuk e lejojnë. Baza e ndalesës të këta është në rregullin e usulit: *veprat shikohen në bazë të qëllimeve të tyre dhe në akte merren parasysh për bazë qëllimet dhe kuptimet dhe jo fjalët dhe fjalitë dhe ligjësimi ndërtohet mbi bazën e realizimit të qëllimit të interesave*. Për këtë arsye ose duhet të merren masa parandaluese ose duhet bërë ndërprerjen e rrugëve që shkaktojnë mosrealizimin e atyre interesave. Nëse Ligjvënësi e parasheh një ligj që të jetë për interes, pastaj e lejon lajkatimin që të anashkalohet ai ligj do të kishte lejuar të kundërtën e atij ligji, e e kundërta e ligjit nuk duhet të ndodhë. Shembull:

Zekati është ligjësuar për të mbuluar nevojat e të varfërve dhe nëse do të lejohej dhurata e cila do ta zëvendësonte ikjen nga dhënia e zekatit, kjo do të nënkuptonte paralizimin e qëllimit të sheriatit dhe do të dëmtoheshin të varfrit.

Shufua është ligjësuar për ta mënjeluar dëmin. Nëse do të ligjësohej diçka, për ta zëvendësuar atë dhe për ta zhvlerësuar do të ishte kthim në zhvlerësimin e qëllimit të sheriatit dhe do të pasohej dëmi i cili degradon atë.⁹⁵

Ibn Tejmije thotë: Ta dish se lejimi i lajkatimit ligjor është krejtësisht ndryshe me parandalimin e rrugëve të këqija sepse Ligjvënësi kur e ndalon

një çështje në të njëjtën kohë i ndalon të gjitha mënyrat dhe rrugët e haramit ndërsa lajkatuesi dëshiron të arrij deri aty. Për këtë arsye, kur Ligjvënësi i parashihet kushtet në shitblerje, kontrata, martesë, i ka paraparë për të mos lejuar rrugët e prostitucionit dhe të kamatës dhe për ta përmbushur qëllimin e akteve. Nga këndvështrimi i jashtëm, lajkatuesi nuk del nga kjo sferë dhe kur lajkatuesi dëshiron të lajkatojë në disa prej këtyre kontratave të cilat i ka ndaluar Ligjvënësi, ai ka ardhur me një lajkatim tjetër me mendimin e tij të arrij në të njëjtën çështje të cilën Ligjvënësi e ka parandaluar, atëherë prej atyre kushteve nuk do të kishte kurrfarë vlere dhe as të vërtete, por do të ishte vetëm tallje dhe mahi.⁹⁶

Ibn Tejmije, çdo lajkatim i cili shkel të drejtën e tjetrit ose çdo veprim që ndikon në veprimin e haramit ose çdo kontratë e cila nuk e plotëson kushtin e shpallë të pavlefshme sepse këto i ka ndaluar Ligjvënësi sepse kjo edhe kërkohet dhe zhvlerësohet edhe pse në esencë ai veprim është i lejuar.

Po ashtu edhe nëse qëllimi i tij është për t'u arritur një çështje e lejuar, vetëm se deri te ajo çështje nuk mund të arrij përpos me veprim të ndaluar (haram). Në këtë rast lajkatimi do të ishte i pavlerë, sepse çështja e ndaluar të cilën e ka shfrytëzuar si mjet për të e lejuara është haram në vetvete, si f.v., ai i cili e përdorë tradhtinë si mjet për ta fituar të drejtën e tij ose dëshminë e rrejshme si mjet për ta fituar të drejtën të cilën e ka fituar me mund. Kjo nuk lejohet sepse tradhtia është haram në vetvete.

Dëmi i cili shkaktohet me dëmin e dëshmive dhe humbjes së besimit është më i madh se dëmi i cili shkaktohet nga humbja e dëmit të një personi të shoqërisë.

Nëse do të bëhej precedent dëshmimi i rrejshëm për të fituar të drejtën, atëherë do të bëhej zakon edhe për të fituar padrejtësisht.

Po të bëhej precedent tradhtia për të fituar të drejtën, atëherë ai do ta bënte zakon që të fitoj atë që dëshiron e nuk i takon, e kështu do të shkaktoheshin trazirat. Harami në vetvete absolutisht nuk lejohet në asnjë rast pos në domosdoshmëri.⁹⁷

Përfundim:

Këtu po e përfundoj me argumentet për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët, esencën e tyre, konceptin e tyre dhe divergjencën e tyre për ato argumente dhe në fund themi: E vërteta është se llogaritja e këtyre argumenteve për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët janë burime dhe argumente globale të cilat sjellin ndonjë lloj lehtësimi. Në realitet ato janë rregulla të fikhut të cilat zbatohen për raste individuale, ashtu siç zbatohen rregullat e tërësishme

tjera të fikhut dhe nuk janë argument global në të cilën duhet bazuar për të përfituar dispozitë fikhore, siç është rasti me argumentet e sheriatit: **Kur'ani, suneti, ixhmai dhe kijasi.**

(shtojcë)

Argumentet tjera të fikhut për të cilat dijetarët nuk janë pajtuar

Ekzistojnë edhe argumente tjera përpos tyre, që për esencën e tyre nuk janë pajtuar dijetarët, më të rëndësishmet janë tri:

- **Baza e çështjeve;**
- **Istikrai, dhe**
- **Të vepruarit me emëruesin e më të vogël të përbashkët.**

Kështu rezulton se argumentet për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët janë dhjetë.

Baza e çështjeve

Në këtë rast qëllimi me fjalën “**bazë**” është – rregull stabil apo permanent me argument të përgjithshëm.

Sa i përket fjalës “**çështjeve**”, qëllimi është – specifikat e veprimeve të njerëzve të cilët kanë të drejtë t’i zgjedhin duke pasur parasysh se kanë të bëjnë me ligjet e të ngarkuarve (njerëzve).

Në këtë kuptim, baza në çështje nuk del nga korniza e dy ligjeve:

a. **Ndalesa në dëmtim.** Bazë e kësaj është thënia e pejgamberit s.a.v.s. “**Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.**” Kuptimi i këtij hadithi është: Mos e dëmto veten tënde dhe mos të dëmtohet tjetri prej teje.

b. **E lejuara përpos kësaj.** Për gjërat e dobishme, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَّا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا

“**Ai (All-llahu) është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë.**” (El-Bekare : 29) sepse pjesëza “**le**”(për) në fjalën “**lekum**” (për ju) është për të specifikuar çka është e dobishme për njerëzit, mirëpo ajo çka është brenda sferës së të dobishmes dhe të dëmshmes, sepse të mosekzistuarit e argumentit për t’i dhënë prioritet veprimit të njërës apo mosveprimit të tjetrës llogaritet argument i sheriatit dhe lejohet të zgjidhet njëra prej tyre.

E gjithë kjo llogaritet pas dërgimit dhe pas pranimit të ftesës së të dërguarit të Allahut s.a.v.s., përderisa para kësaj, te Esharijtë gjykohet se nuk ka obligueshmëri para dërgimit sepse presupozohet se nuk ka ligjshmëri.

Te Esharijtë, në ligjësimin e ligjit sheriatik, logjika nuk është e pavarur.

Të kundërtën e thonë muëtezilët, dhe në bazë të kësaj duhet që njerëzit të arsyetohen, dhe nuk e kanë obligim nëse veprojnë dhe nuk kanë mëkat nëse nuk veprojnë. Argumentohen me thënien e Zotit të Lartmadhëruar

وَمَا كُنَّا مُعَذِّبِينَ حَتَّىٰ نَبْعَثَ رَسُولًا

“**E Ne nuk dënuam askënd para se t’ia dërgojmë të dërguarin.**”

Konkludohet se, te shumica absolute e dijetarëve, çështjet konsiderohen të lejuara deri sa të mos sillet shpallje për ndalesë apo për obligueshmëri.¹

Istikrai

Istikra: do të thotë atëherë kur pjesët e çështjes së tërësishme shpërndahen për të aprovuar ligjet e saj për atë çështje ose për aprovimin në çështjen e tërësishme të atyre pjesëve. Istikrai është dy llojesh:

- i plotë, dhe
- i mangët.

Istikrai i plotë – është shpërndarja e pjesëve të shumta, përpos një pjese për të cilën nuk pajtohen (dijetarët) me disa forma tjera.

Nëpërmjet Istikrait ekspertët arrijnë deri te aprovimi i ligjit të çështja mospajtuere prej rrugës së aprovimit të tërësishëm që e përfshijnë atë.

Ky aprovim i prerë ligjor aprovohet varësisht prej argumentit të zakonit dhe atij logjik dhe kjo **nëse është istikrai i plotë dhe hamendës**.

Nëse istikrai është i mangët - te fukahatë është e natyrës së të barturit të individit i rrallë me atë të shumtën dhe të përgjithshmes. Raste të tilla gjenden në libra të shumtë të fikhut.

Shembull të istikrait të plotë - Nëse parashtrohet pyetja për prapaskenën e namazit të vitrit, se a është farz apo sunet, po të ishte namazi i vitrit vaxhib nuk do të ishte (lejuar) falur edhe në mjet transportues. E dyta është e pavlefshme.

Argumenti i patjetërsueshëm: Ajo çka është konfirmuar në vazhdimësi të plotë mbi të gjitha vaxhibet, qoftë falja e tyre në kohë ose kada, përpos rastit të çështjes së mospajtimit (vitrit) ashtu që është vërtetuar se nuk ka çështje tjetër e cila kryhet në mjet transportues pos saj.

Istikrai është argument te Shafijjtë, Malikijtë dhe Hanbelijtë.²

Hanefijtë nuk e pranojnë istikrain në cilësinë si argument i pavarur për aprovimin e dispozitës, pasi që disa prej tyre shkojnë në atë drejtim të bazës së Kijasit kur tregon për një atribut i cili atribut llogaritet si pikë e bashkimit të të gjitha pjesëve të çështjes ose ata bazohen në zakonet ose në traditën.

Të vepruarit me minimumin

(Emëruesi më i vogël i përbashkët) E cila është thënë te Shafiijtë.

Esenca e të vepruarit me minimumin³ (siç e kemi përmendur) atëherë kur dijetarët ndahen për dispozitën e një çështje prej çështjeve, si f.v., mospajtimi për “DIJEN” e minorenit:

- Hanefijët mendojnë se është i njëjtë me “DIJEN” e muslimanit.
- Malikijët mendojnë: ajo është sa gjysma e “DIJES” së muslimanit.
- Shafiijtë thonë se është sa një e treta e “DIJES” së muslimanit, këtë e thonë duke u bazuar në emëruesin më të vogël të përbashkët të përmendur nga dijetarët duke mos shtuar më shumë, përderisa nuk paraqitet argument për shtesë.

Nëse paraqitet argument për shtesë, atëherë duhet pasuar atë argument (shtesë) sepse bazës nuk duhet qëndruar kundër. Shembull të kësaj e kemi mendimin e Shafiijtut: Minimumi i xhizjes nëse nuk do të kishte argument për shtesë është një dinarë.

Me këtë ka vepruar Shafiiju dhe Ebu Bekri Bakilani.

Tregohet nga disa ekspert të ushtrisë për ixhmain e analistëve se, në esencë kjo është vetëm bashkëngjitje për të vepruar me të deri sa të mos paraqitet ndonjë argument i cili tregon për të vepruar me maksimumin.

Shafiijtë veprojnë edhe me emëruesin më të madh të përbashkët me rastin e numrit të pastrimeve, pasi që është thënë për pastrimin e enës prej lëpirjes së qenit, ai pastrim i enës bëhet tre herë, pesë herë ose shtatë herë,⁴ mirëpo lajmi (hadithi) i dy koleksioneve sahihë tregon se duhet pastruar shtatë herë.⁵ Në këtë rast nuk është vepruar me minimumin e thënë (por me maksimumin).

Shafiiju, Maliku dhe Ahmedit thonë se “DIJA” e idhujtarit është sa tre e dhjeta e DIJES së muslimanit, që do të thotë, dy pjesë nga tri e dhjeta pjesë e DIJES së muslimanit.

Ebu Hanife thotë se është e njëjtë me DIJEN e muslimanit dhe të pasuesit të librit.

Shumica absolute thonë se duhet të veprojnë me minimumin.

Kur Shafiiju r.a. e ka zgjedh për të vepruar me minimumin para mendimeve të dijetarëve, ai ka vepruar me më të sigurtën. Për këtë arsye ai i kushtëzon tre kushte:

E para: Që të mos gjendet ndonjë argument për specifikimin e tij.

E dyta: Që të mos jetë çështje në procesin për të cilën ka pasur mospajtime, si f.v., namazi i xhumasë është aprovuar duke kaluar në procesin në të cilën dijetarët kanë paraqitur mospajtime në lidhje me numrin e xhematit të cilët bëhen shkak i vlefshmërisë së namazit të xhumasë. Në këtë rast nuk veprohet me minimumin, argument i kësaj është peng i dënimit për të dhe dënimet nuk zbatohen kur të ketë dyshim për veprën. Për këtë arsye, Shafiiju e ka paraparë se për pranimin e xhumasë nevojiten 40 xhematë dhe ky është maksimumi i numrit të xhematit për të. Kjo do të thotë se nëse dispozita është e aprovuar në “DHIME” atëherë merret maksimumi, ky argument është për Shafijët sepse borxhi kryhet me maksimumin sipas ixhmait, ndërsa për minimumin e saj ka mospajtime.

E treta: Që minimumi të jetë në pajtueshmëri prej të gjithë protagonistëve për atë çështje.

Nëse nuk plotësohet kushti i parë dhe gjendet ndonjë argument i cili tregon për një çështje konkrete, atëherë përcaktohet të veprohet në bazë të asaj çështjeje konkrete, ashtu siç e treguam me të vepruarit me çështjen e lëpirjes së qenit.

Nëse nuk plotësohet kushti i dytë ashtu që çështja është në proces debati për të cilën ka divergjenca, përcaktohet të veprohet me shumicën sepse kjo është më e përshtatshme, siç e treguam me numrin e xhematit me të cilën pranohet namazi i xhumasë, që do të thotë: Të vepruarit me më të përshtatshmen nuk është vaxhib, vetëm poqëse çështja për të cilën debatohet merr rezultat të sigurt përfundimtar. Nëse çështja për të cilën debatohet nuk është temë e debatit për atë për të cilën duhet të veprohet minimumi. Në këtë çështje bëhet obligative edhe pse ka mospajtime.

Nëse nuk plotësohet kushti i tretë: Nuk përcaktohet emëruesi më i vogël i përbashkët, për shkak të pasigurisë së saj dhe sikur Shafijët e kanë paraparë të vepruarin me minimumin si emërues i përbashkët i ixhmait për pranimin e minimumit dhe pafajësinë esenciale (në rastin e mohimit) të cilën e dëshmon logjika sepse ajo nuk nënkupton se nuk duhet të shtohet sepse absolutisht, bazike është të mos jetë obligative, mirëpo nuk veprohet me minimumin sepse është aprovuar ixhmai (të mos veprohet) dhe çka është pas saj mbetet në bazën e saj.

Sqarim i kësaj është se, kur Shafiijtë deklarojnë për “DIJEN” e minorenit, se veprohet me minimumin, ato kanë shikuar se për një të tretën janë pajtuar që të gjithë sepse ai i cili ka thënë për një të dytën, ai ka dhënë edhe për të sepse një e treta është edhe brenda një të dytës, ai i cili deklaron një të njëjtën edhe ai e ka thënë një të tretën sepse një e treta bën pjesë brenda tërësisë. Kjo i bie se, për një të tretën janë pajtuar që të gjithë, sepse në momentin kur janë pajtuar që të mos ketë shtesë tjetër, ata kanë vërejtur se baza e çështjes nuk ka më dispozitë shtuese dhe kjo është pajtueshmëria e bazës prej ixhmait.

Njësoj është edhe për shumën e XHIZJES.

Është thënë: katër dinarë.

Është thënë: dy dinarë.

Është thënë: një dinarë.⁶

- Shafiiju vepron me shumën e një dinarit, sepse ky është emëruesi më i vogël i përbashkët.

- Të tjerët pajtohen me të (në një dinarin), por mospajtimi është për me mbi një dinarin. Këtë mendim e mbështesin me hadithin mursel nga Umer bin Abdul Azizi, të cilin e transmeton Shafiiju në Musnedin e tij,⁷ dhe hadithin e Muhamedit a.s. nga Muadhi se, pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëruar që të merret nga një dinarë për banorët e Jemenit.⁸

- Hanefijët nuk e pranojnë këtë bazë juridike, ashtu siç nuk e pranojnë ixhmain e aprovuar në këtë mënyrë sepse te ta, ky lloj i ixhmait nuk është i plotë, pos nëse ekziston mundësia e saktësisimit të mendimeve të cilat burojnë prej dijetarëve në lidhje me këtë çështje, ndërsa kjo mënyrë është e papranueshme.

Për këtë arsye Ibn Hazmi deklaron: Lejohet të veprohet me minimumin, nëse mund të mbledhim saktësisht mendimet e të gjithë dijetarëve islam, mirëpo tek kjo nuk është arritur sepse është thënë se duhet të veprohet me maksimumin e thënë, që me bindje të lirohet prej sferës së obligueshmërisë.

Hanefijët e shtojnë edhe mendimin e tyre se, të vepruarit me të gjitha mendimet me rezervë sepse kështu kryhet obligimi në mënyrë të prerë.

Është replikuar se, të vepruarit me rezervë nuk është obligim, vetëm poqëse kryerja e obligimit është obligim i sigurt si, f.v., agjërimi i muajit ramazan, obligueshmëria është e zënë përderisa agjërimit tjetër në atë ditë kur nuk shihet hëna e re e muajit sheval konsiderohet veprim rezervë që automatikisht të bëhet lirimi nga ngarkesa me agjërimin e asaj dite, por kur

nuk është në pyetje lirimi nga ngarkesa (detyra) që nga esenca, atëherë të vepruarit me minimumin është e sigurt dhe të vepruarit me të është rezervë.

Burimet e fikhut të cilat nuk janë të sheriatit

Islami nuk pranon që të veprohet me asnjë burim i cili nuk ka mbështetje të sheriatit ose të shpalljes qoftë direkte qoftë indirekte. Mjafton t'i përmendim disa burime të papranuara e ato janë:⁹

1. Ligjësimi i mendjes njerëzore (ligjet njerëzore).

Te juristët, kushtetuta ka dy kuptime:

E para: Kuptim të përgjithshëm.

E dyta: Kuptim të veçantë.

E para: Ligjësimi në kuptim të përgjithshëm.

Ligjësimi në kuptim të përgjithshëm është: **Vendosja e rregullave ligjore të domosdoshme, për ligjin i cili i rregullon raportet shoqërore të njerëzve, pa marrë parasysh se ato rregullore a rezultojnë ndonjë burim prej burimeve legislative apo të ndonjë interpretimi të rregullave ekzistuese.**

E dyta: Ligjësimi në kuptim të veçantë.

Ligjësimi në kuptim të veçantë është: **Shprehje e dëshirës së qeverisë qendrore.** Me të, pikësynohet vendosja e rregullave ligjore dhe obligimin e njerëzve për t'i respektuar ato në të gjitha shtetet në krahasim me ligjin e përgjithshëm, pasi që absolutisht këtë kuptim e ka ligjësimi kur të shprehet.

Pushteti i përgjithshëm i cili aprovon ligje mund të jetë i zbatueshëm në sisteme mbretërore por mund të jetë edhe në sisteme parlamentare, ku si përfaqësues të popullit vendosin ligje për popullin siç është në sisteme shtetërore, por mund të jetë edhe më shumë se kaq, por që mundet edhe populli të merr pjesë direkt me vendosjen e ligjit themelor të shtetit siç është kushtetuta.

Si do që të jetë çështja, këto qeverisje në vendosje të ligjit mbështeten në rezultatet e mendjes njerëzore dhe të ideve me liri absolute, siç shihet qartë në definicionin ku nënvizohet se, ligjësimi shpreh dëshirën e qeverisjes së

përgjithshme, e cila mund të jetë e një individi apo të individëve. Kështu pra, ligjësimi është prodhim i mendjes, bile edhe sinonim i saj.

Mendja (e lirë) absolute: Tek fukahatë e sheriatit islam nuk konsiderohet burim prej burimeve të fikhut islam sepse nuk mund të rezultojë drejtësi dhe barazi e cila kërkohet në ligj. Kjo, nga shkakut se mendjet njerëzore ndryshojnë njëra prej tjetrës në perceptimin e çështjeve dhe ndryshojnë barometrat e së mirës dhe së keqes sipas këndvështrimeve të tyre. Është i kufizuar në perceptimin e esencës së çështjeve të mjegulluara dhe nuk mund të zbuloj atë që ndodh në të ardhmen prej ngjarjeve, sikurse edhe nuk është imun prej nxitjes së epshit, dëshirave dhe apetiteve.

Në fund, rezultati i çështjeve nuk mbështetet mbi bazën e fesë dhe moralit, gjë që shpie që ligjet dhe rregullat të jenë prodhim njerëzor dhe gjithmonë është i mangët që të arrihet drejtësia, interesi dhe qetësia. Për këtë kemi fakte të shumta në ndryshimin e atyre ligjeve, aneksimet e atyre ligjeve, rishqyrtimin për revidimin dhe mënjanimin e mangësive pas një kohe të themelimit të tyre.

Që vetëm mendja të mos llogaritet burim prej burimeve të ligjeve në fikhun islam është çështje për të cilën janë pajtuar fukahatë e sheriatit islam dhe ne e shohim se ata vazhdimisht deklarojnë “Nuk ka ligjësim, pos ligjit të Zotit të botëve.” dhe nuk është veçuar nga kjo askush, saqë edhe fukahatë muëtezil të cilët deklarojnë se *mendja i percepton disa punë të mira, të cilat i bën se janë të urdhëruara për të dhe nëse i vepron meriton shpërblim, dhe kjo siç është drejtësia dhe besnikëria dhe disa çështje tjera të cilat i percepton se janë të këqija dhe që duhet larguar prej tyre dhe për veprimin e tyre meriton ndëshkim, siç janë gënjeshtria, vrasja, etj.*, muëtezilët e deklarojnë këtë për arsye se, mendja nuk i ligjëson këto ligje dhe nuk i miraton, por gjenerues dhe ligjësues është Allahu, Krijuesi i të gjithë botëve, dhe aktiviteti i mendjes është i mangët për t’i kuptuar ligjet e Allahut të Lartmadhëruar në këto çështje nëpërmjet perceptimit të së mirës vetanake dhe të keqes vetanake. Kur ta perceptojë se në diçka ka të mirë e ka perceptuar ligjin e Allahut në atë çështje dhe e përcakton të veprohet dhe kur ta perceptojë se në një çështje ka të keqe, e percepton ligjin e Allahut në të dhe e përcakton largimin prej saj dhe njeriu nuk tejkalon kufijtë e veprimit të mendjes në kuptimin dhe perceptimin e ligjit, vetëm se gjenerues dhe vendosës i vet ligjit është Zoti, Krijuesi i gjithë botëve.

Megjithatë, ehlu suneti e kanë konsideruar të pavlefshëm mendimin e muëtezilëve në këtë çështje, siç shihet kur lexohen librat e fikhut kur të tregohet për temën e qeveritarit.

Mbështetja në mendje me atributin e tij si burim i ligjeve, nuk ka ekzistuar në kohën e Muhamedit a.s. dhe as në gjeneratën pas tij. Në kohën e Muhamedit a.s., çdo ligj i cili ka ardhur ka ardhur prej Kur'anit fisnik si shpallje prej qiellit, siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar:

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٩٢﴾ نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ ﴿١٩٣﴾ عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿١٩٤﴾ بِلسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ ﴿١٩٥﴾

“E edhe ai (Kur’ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). (E solli) Në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber). (Të shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe.” (Esh-Shuaraë : 192-195)

dhe po ashtu ligjet të cilat burojnë, burojnë edhe nga suneti siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar:

وَلَوْ تَقَوَّلَ عَلَيْنَا بَعْضَ الْأَقَاوِيلِ ﴿٤٤﴾ لَأَخَذْنَا مِنْهُ بِالْيَمِينِ ﴿٤٥﴾ ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ الْوَتِينَ ﴿٤٦﴾ فَمَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ عَنْهُ حَاجِزِينَ ﴿٤٧﴾

“Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë! Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë. E pastaj do t’ia këputnim atij arterien e zemrës. Askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij.” (El-Hakatu : 44-47)

Përderisa, pas epokës së Muhamedit a.s., detyra e muxhtehidëve është vetëm zbulim dhe shpalosje e ligjeve, të cilat i kuptojnë prej teksteve dhe i zbatojnë ato, dhe bëjnë analogji me ta dhe bëjnë ixhtihadë për t’i nxjerrë ligjet prej tyre, dhe assesi nuk vendosin ligje prej mendjes së tyre dhe nuk janë themelues të ligjeve prej mendjeve dhe ideve të tyre, sepse ata mbështeten në Kur’an dhe sunet për zbulimin e ligjeve dhe sqarimin e tyre, dhe nuk mbështeten në diçka tjetër, pa marrë parasysh a është ixhtihadi individual apo kolektiv. Rezultati i çështjes së ligjit për të cilën janë pajtuar muxhtehidët është obligim për umetin dhe pas kësaj për atë çështje skadon afati i ixhtihadit.

Nëse ligji është vendosur nga ixhtihadi i individit, nuk është obligim për të gjithë muxhtehidët tjerë, por është obligim për vet muxhtehidin e asaj çështjeje dhe për secilin pasues për të cilët e ka dhënë atë mendim.

Në islam, të drejtën e legjislativit e ka Allahu, Krijuesi i botëve, dhe i dërguari s.a.v.s., nga shkak se është ai është i dërguar dhe transmetues i shpalljes së Allahut tek njerëzit dhe në islam të drejtën e legjislativit nuk e ka askush tjetër, qoftë individual qoftë kolektiv, ashtu siç e sqarova edhe më herët.

Kur të përdoret fjala ligjësim për veprën e muxhtehidëve, dhe kur ta përdorim fjalën ligjësuës për muxhtehidin apo qeveritarin, ne e përdorim në mënyrë metaforike dhe jo në kuptimin e drejtë të fjalës.

Vendin e organit legjislativ në islam e zë kuvendi i planifikimit të lartë, i cili bazohet në sistem konsultativ, dhe nuk ka kurrfarë pengese që të bazohet në sistem parlamentar brenda kornizës së aprovimit të rregullave procedurale, të bazuar mbi themelin e ligjit qiellor, si për shembull ligjin e punës dhe punëtorëve, ligji i sigurimeve shoqërore, ligji i punëtorëve administrativ dhe ligjet e shfrytëzimit të pasurive natyrore si mineralet, etj.

Autorizimi

(Me **autorizim** nënkuptohet) Dhënia e së drejtës për të ligjësuar prej pejgamberit a.s. tek ndonjë dijetar, për çështje dhe ndodhi, që të ligjësoj çka dëshiron pa argument mbështetës, e që ai ligj i tij më pastaj të jetë i drejtë dhe në përputhshmëri me ligjin e Allahut sepse është i inspiruar prej Allahut.

Këtë burim ligjor nuk e pranon askush përpos shiitëve imamij. Për këtë arsye, shiitët thonë se imamët e tyre janë të pagabueshëm, sepse Imamët e tyre kanë autorizim të argumentimit, dhe se çka buron prej tyre dhe çdo mendim i tyre është i saktë dhe në përputhshmëri me vendimin e Allahut.

Ehlu suneti, varësisht prej mendimeve të ndryshme të tyre – *siç e kemi përmendur në temën e ixhmait dhe ixhtihadit* – nuk e pranojnë se ekziston një autorizim i tillë, dhe nuk e llogaritin si argument dhe burim të sheriatit, sepse ligjet janë prej Allahut të Lartmadhëruar dhe transmetohen nëpërmjet Xhibrilit a.s. si transmetues i shpalljes.

Sa i përket inspirimit:

- mund të jetë prej Allahut të Lartmadhëruar, por mund të jetë edhe prej shejtanit, siç Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِنَّ الشَّيَاطِينَ لَيُوحُونَ إِلَىٰ أَوْلِيَائِهِمْ لِيُجَادِلُوكُمْ ۖ وَإِنْ أَطَعْتُمُوهُمْ إِنَّكُمْ لَمُشْرِكُونَ

“Shejtanët i nxisin miqtë e vet që t’ju polemizojnë juve, e nëse i dëgjoni ata, atëherë jeni si ata (idhujtarë).” (El-En’am : 121)

Por është e mundur të jetë prej imagjinatës dhe vesveseve të tij siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ وَنَعْلَمُ مَا تُوَسْوِسُ بِهِ نَفْسُهُ ۖ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe e dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (që rreh) i qafës së tij.” (Kaf : 16)

Pasi që ekzistojnë të gjitha këto mundësi, atëherë inspirimi nuk mund të jetë argument.

Nga ky lloj është edhe ajo të cilën e mendojnë disa sufistë, se inspirimi apo zbulimi është argument dhe duhet të veprohet me të, në konceptin të cilin e përmendin më sipër, mirëpo kjo është e papranueshme sepse inspirimi apo zbulimi nuk është argument, ashtu siç e sqarova në pjesën e replikës me shiitët.¹⁰

Ligji Zëvendësues

Te juristët, **zëvendësimi** definohet si një hallkë legislative e cila nuk është prej burimeve të fikhut islam për muslimanët, me të cilën hallkë përpilohen ligje tjera të cilat e zëvendësojnë sheriatin islam, duke aluduar në përmirësimin dhe kompletimin e tij pas vdekjes së të dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Përderisa, sa i përket jomuslimanëve, prej minorenëve, të cilët janë rezidentë të shtetit islam dhe llogariten banorë të shtetit islam, dispozitat ligjore nuk janë të plotfuqishme në ritet dhe adhurimet fetare të fesë së tyre, sepse jemi të urdhëruar që t'i tolerojmë e të respektojnë fenë e tyre.¹¹ Për këtë ekziston edhe ixhmai i të gjithë dijetarëve islam.

Përderisa, sa i përket pos kësaj:

Shumica absolute e dijetarëve mendojnë se ata duhet t'i nënshtrohen ligjeve të sheriatit, nëse e kundërshtojnë, ata detyrohen të respektojnë sheriatin, dhe edhe në mes vete ata i zbatojnë ligjet e sheriatit.

Ebu Hanife shkon në atë drejtim se, atyre nuk ju obligohet ajo çka parasheh feja e tyre në dispozita të marrëdhënieve reciproke sipas fesë së tyre, por gjykohet në mes tyre me ligjet e tyre, vetëm nëse raportet ndërnjerëzore kanë të bëjnë me ndonjë të drejtë prej të drejtave të muslimanëve, atëherë në këto raste zbatohen ligjet e sheriatit islam. Kjo zbatohet për të penguar dëmin ndaj muslimanëve, si f.v., kur një minoren martohet me një minorene të cilën e ka shkurorëzuar muslimani dhe ajo është në IDDETIN e saj, ai duhet të zbatoj ligjet e sheriatit islam, duke i ndarë në mes tyre, për të siguruar të drejtën e muslimanit dhe për të penguar dëmin i cili mund të shkaktohet duke u martuar me tjetrin gjatë fazës së shkurorëzimit, derisa është në iddet.

Studentët e Ebu Hanifes shkojnë në atë drejtim duke mos i obliguar, por në mesin e tyre gjykohet me ligjet e sheriatit islam për gjërat për të cilat janë pajtuar ata, si f.v., ndalesa e të martuarit me nënën, motrën dhe vajzën, dhe të martuarit me më shumë se katër gra. Përderisa sa i përket dispozitave për të cilat nuk ekziston ixhmai i sheriatit islam, gjykohet në mes tyre në bazë të ligjeve të fesë së tyre. *Kush dëshiron më shumë, le të kthehet te librat e fikhut të drejtimit Hanefijë.*¹²

Nga kjo shihet se, Ebu Hanife është ai i cili thotë për zëvendësimin ligjor (IHALE) në ligjet e minorenëve, *nëse nuk e dëmtojnë asnjë musliman*, por studentët e Ebu Hanifes e lejojnë zëvendësimin ligjorë (IHALE) për çështje për të cilat ekziston ixhmai në sheriati islam, mirëpo ky zëvendësim ligjor (IHALE) nuk është burim i fikhut islam, ose mbështetje në ligjet tjera për t'u kompletuar sheriati, por është vendosur si tolerancë me minorenët jomuslimanë, që t'u lihet liri në adhurimet e tyre dhe në kryerjen e riteve të tyre fetare dhe përdorimin e simboleve fetare të tyre dhe çka kanë për detyrë t'i zbatojnë ligjet e marrëdhënieve reciproke. Nuk ka dyshim se kjo tolerancë llogaritet prej **madhështisë islame**.

Përderisa sa i përket *traditës* dhe *ligjit para nesh*, këto nuk janë prej çështjes së zëvendësimit ligjor (IHALES), sepse tradita ose ligji para nesh nuk janë të pavarura për ne, por për shkak se sheriati islam i ka aprovuar që ndonjëherë të mbështetemi te ta, për t'u bazuar në traditë për t'i plotësuar nevojat dhe për t'i realizuar interesat dhe për të mënjeluar vështirësitë dhe për të lehtësuar obligimet, përderisa ligji para nesh bazën e ka në Kur'an dhe sunet siç e kuptuam më parë.

Ligji romak

Disa orientalistë pretendojnë se fikhu islam është ndikuar nga ligji romak, saqë disa prej tyre e kanë tepruar duke deklaruar se ligji romak është burim prej burimeve të fikhut islam. Pretendimet e tyre këta i mbështesin në dy çështje:

E para: Kronologjisht, ligji romak është më i hershëm se fikhu islam.

E dyta: Ngjashmëria e ligjit romak dhe fikhut islam në disa rregulla dhe terminologji, si f.v., rregulli *akuzuesi sjell fakte ndërsa i akuzuari përбетohet*, është vetëm një rregull e përbashkët e dy ligjeve prej shumë rregullave. Pastaj rregulli i parimit të interesit, i cili është parim i interesit të përgjithshëm në ligjin romak, gjë që sipas tyre tregon se ligji romak ka ndikuar në fikhun islam. Ky ndikim ka kaluar në dy faza:

E para: Faza e zanafillës së kohës së peygamberit s.a.v.s., kur siç pretendojnë, peygamberi s.a.v.s. kur ka udhëtuar në Siri ka pasur mundësi të mësoj ligjin romak të Bizantit.

E dyta: Faza e zhvillimit në kohën e sehabëve, tabiinëve dhe muxhtehidinëve, të cilët kanë gërshtuar sheriatin islam me ligjin romak në vendet të cilat i kanë çliruar muslimanët, si f.v., Sirinë dhe Egjiptin.

E gjithë kjo është e pavlerë, sepse burimet e sheriatit islam janë të pavarura dhe bazën e kanë vetëm te vullneti i Krijuesit të botëve.¹³

1. Kjo temë “Masat ligjore në politikën e sheriatit dhe të fikhut islam” është të cilën e kam punuar si temë diplome në “Institutin e sheriatit të fakultetit të drejtësisë”, Universiteti i Kajros, viti 1959.
2. “El-muvafekat”, 4/198, Shatibiu.
3. “I’elamul mukiijn”, 3/147.
4. “El-furukë”, 2/33.
5. “Ibni Hanbeli”, 314, Ebu Zehra.
6. E ka regjistruar Muslimi nga Ebu Hurejre, se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Mos xhelozoni, mos mashtroni, mos urreni, mos polemizoni dhe mos ndërhyini në shitblerjet e njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Allahut si vëllezër. Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e nënçmon, nuk e përgënjeshton, nuk ia zbulon të metat. Devotshmëria është këtu – duke sinjalizuar në gjoksin e tij tri herë. Mjafton për muslimanin t’i bëj keq vetëm duke e nënçmuar vëllain e tij. Çdo gjë e muslimanit është haram për muslimanin: gjaku i tij, pasuria e tij dhe nderi i tij.
7. E kemi treguar transmetimin e hadithit për ndërhyrje të shitblerjes së vëllait dhe fejesën e të fejuarit të vëllait, ndërsa te Muslimi është edhe shtesa: Muslimani nuk ndërhy në pjesën e vëllait të tij. (“Subules-Selam”, 3/3.
8. “I’elamul mukiijn”, 3/147.
9. “Sijasetush-Sheriati”, 69, Abdurrahman Taxh.
10. “El-muvafekat”, 2/313.
11. “El-furukë”, 3/33.
- “El-muvafekat”, 2/352.
12. “El-Furukë”.
- “Ibid”, 32.
- “Ibni Hanbeli”, 321, Ebu Zehra.
- “El-muvafekat”, 2/352.
- “Mugnil muhtaxh”, 1/38.
13. “Malik bin Enesi”, 407, Ebu Zehra.
- “Usuli fikh”, 275, Ebu Zehra.
- “Ibni Hanbeli”, 15, Ebu Zehra.
14. “El-munteki alel muvettaë”, 5/17.
15. “El muvafekat”, 2/349, botues Et-Tixharije.
16. Ibid, 2/348.
- Ibni Hanbel, 317, Ebu Zehra.
17. Ibni Hanbeli, 318.
- Hadithi i “ndalimit në periferi”. Transmeton Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi nga Ibni Mes’udi. Po ashtu e kanë transmetuar autorët e “suneneve” nga Ebu Hurejre përpos Buhariut, në të tregohet për të drejtën e zgjedhjes së blerësit të mallit kur ta sjell në treg. (“Nejlul Evtar”, 5/116).
18. Transmeton Ahmedi dhe Ebu Davudi nga Muamer Abdullah el Adevij. (“Nejlul Evtarë”, 5/230).
19. “Ibni Hanbeli”, Ebu Zehra.
20. “I’elamul mukiijn”, 3/148.

21. “El-muvafekat”, 2/348.
22. “El-muvafekat”, 2/358.
23. Ibid, 2/359.
24. Ibid, 2/361.
- “Mugnil muhtaxh”, 2/37.
25. “El-muvafekat”, 2/361.
26. Transmeton Muslimi nga Aishja r.a. se e ka ndaluar delegacionin nga Abul Kajsi që të veprojnë me DHUBAE, NEKIJR, MUZEFE dhe HATEM. Ngjashëm është edhe hadithi i transmetuar te Buhariu dhe Muslimi nga Ibni Abasi, Enesi dhe Ebi Hurejre: DHUBAE, HATEM, NEKIJR, MUZEFET, MUKIJR.
27. E kemi treguar transmetimin. (“Xhamiul usul”, 7/427).
28. E kanë regjistruar dy shejhët nga Ebi Hurejre: Zoti i mallkoftë jehudët, të cilët varret e pejgamberëve i kanë shndërruar në faltore. Në sahihun e muslimit qëndron: Mos u ulni mbi varre, mos u falni para tyre dhe mbi ta. Arsyeja e kësaj është që kjo të jetë masë ligjore.
29. .
30. .
31. Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi dhe Nesaiju nga Umi Selmete, të cilës i ka vdekur burri i saj të mos vishet me rroba...
32. Ky është hadithi i Amr bin Shuaibit: Nuk lejohet borxhi dhe shitblerja... Transmetojnë Ahmedi dhe autorët e suneneve Ibn Huzejme dhe Hakimi.
33. Transmeton Karevijni dhe Ibni Maxhe nga Enesi: Kur ndonjëri nga ju jep borxh dhe i jepet dhuratë ose i mundësohet të shfrytëzoj kafshë shtëpiake, mos të hipë në tëdhe mos ta pranoj dhuratën, pos nëse ka ndodhur (ka qenë zakon) në mes tyre para borxhdhënies. Në zinxhir ka persona të panjohur. Te Buhariu, në librin “Historia e tij” nga Enesi ekziston: Nëse jep borxh, të mos pranoj dhuratë (nga borxhmarrësi). (“Xhemul fevaidu”, 1/673; “Err-Rrevdatu en-Nedijeti”, 2/126-127).
34. E kemi treguar transmetimin.
35. E ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Seid el Hudriju se pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar agjërimin 48 orësh (dy ditësh), ditën e fitrit dhe të kurban bajramit. (“Subules-salam”, 2/169).
36. “El-med-hal ila medhheb Ahmed”, 138.
- “El-muvafekat”, 2/361, 4/198-200
37. “İlâmul mukijjn”, 3/171.
38. “El-muvafekat”, 3/305.
39. “Usulul ameti”, 414.
40. “El-um”, 3/272.
41. Vetëm se Sebekij, dijetar shafiiijë ka thënë: Në çështjen e “ndalimit të ujit” Shafiiju ka pasur për qëllim për ndalimin e mjeteve dhe jo “masë parandaluese” sepse mjetet patjetërsojnë deri te arritja e qëllimit. Mendimi i Shafiiut është për cungimin e dëmit dhe jo parandalimin e saj. (“Hashijetul atar ala sherhil mehalij ala xhem’il xhevamiu li sebekij”, 2/364).
42. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Nuëman bin Beshiri r.a.
43. E ka përmendur Esh-Shevkaniju në librin “İrshadul Fuhulë”, 217, siç është përmendur në “Nejlul Evtarë”, 5/105.

44. E ka përmendur Esh-Shevkaniju në librin “Irshadul Fuhulë”, 217. Kjo vërehet në fund të hadithit të en-Nuëman bin Beshirë: Sikurse bariu i cili ruan rreth një gremine dhe ekziston mundësia të bie në të.
45. Transmetojnë Ahmedi dhe Darumi në musnedet e tyre e zingjir të mirë nga Vabidati bin Muidi në formën e tekstit: Mëkat është ajo çka ta ngushton gjoksin dhe ta dridh zemrën edhe po që se të pyesin njerëzit dhe japin përgjigje për ty.
46. Hadithi i mëparshëm fillon me thënien: Pyete zemrën tënde dhe përfundon me thënien e Muhamedit a.s. edhe nëse të pyesin njerëzit dhe japin përgjigje për ty.
47. E ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah bin Amri. E ka transmetuar Ebu Davudi në sunenin e tij. “Subules-selam”, 4/166; “Suneni i Ebu Davudit”, 2/629).
48. E kemi treguar regjistrimin e hadithit.
49. “İlâmul mukijîn”, 3/149-217.
50. “El-muvafekat2, 4/400.
“El-furukë”.
- “İbni Hanbeli”, 324.
51. Shatibiu në librin “Muvafekatë” thotë: “Ekzistojnë argumente të cilat dëshmojnë për masat ligjore parandaluese në mënyrë të përgjithshme. Për këtë ekziston edhe unanimiteti, por mospajtimi qëndron në masën e veçantë parandaluese të llojit të shitblerjes së quajtur “AXHAL”.”, 3/304.
52. Malikijtë bëjnë dallimin në mes të këtyre dy llojeve dhe thonë: “Shitblerja “AXHAL” është blerja e klientit nga shitësi, apo i autorizuari i tij për një afat të caktuar. Pjesa “nga shitësi i tij” ka të bëjë me shitjen, ndërsa pjesa “për një afat” ka të bëjë me blerjen, që do të thotë, dy kontrata (e para me afat të caktuar, ndërsa e dyta e menjëhershme) kanë ndodhur në mes të kontraktuesve.
- Përderisa, sa i përket shitblerjes “AJNIJE” është atëherë kur një person i thotë një personi tjetër: Bleje këtë mall për dhjetë me pagesë të menjëhershme dhe unë do ta marrë nga ti për dymbëdhjetë me afat të caktuar.
53. .
54. “Bidajetul muxhtehid”.
55. “Mugnil muhtaxh”.
56. “Irshadul fuhulë”.
57. “Irshadul fuhul”.
- “İbid”.
- “El furukë”.
- “Tehdhibil furukë”.
58. E ka regjistruar Maliku në “Muvetaë”, mevkuf nga Umeri, është hadithë me zinxhir të prerë. E kanë transmetuar Ebu Davudi dhe Bejhekiu si hadithë mursel. E ka transmetuar Hakimi nga Ebi Hurejre, merfuë dhe në isnad. (“Nejlul Evtarë”, 1/291).
59. E ka transmetuar Hasaf Ebu Bekri Err-Rraziju nga Aishja dhe ekziston në “Musnefin” e Ibni Shejbetës dhe Abdu Rrezakut është thënie e Sherijhut: Nuk lejohet dëshmia e djalit për prindin e tij dhe as e prindit për djalin e tij dhe as e gruas për burrin e saj dhe as e burrit për gruan e tij, etj. (“En-nasburr-Rrajeti”, 4/83).

60. Transmeton Ebu Davudi nga Ibni Umeri r.a., për isnadin e tij ka vërejtje. E ka transmetuar Ahmedi, në transmetim është Atau, ndërsa transmetuesit janë të besueshëm. E ka saktësuar Ibnul Katani. “Subules-selam”, 3/41).
61. E ka regjistruar Abdurr-Rrezaku në “Musnefin” e tij nga Aishja r.a. (Regjistrimi i haditheve në librin “Tuhfetul fukahae”, autor prof. El-Kenaniju, 2/71).
62. “El-furuk”, 3/265.
63. “Irshadul fuhulë”, Shevkaniju.
64. Ibid.
65. “El-Furukë2.
66. Hadithë “mufefikun alejhi” prej Buhariut dhe Muslimit nga Ebi Seid el Hudriji dhe Ebi Hurejre r.a.
Xhenibë – e mirë, apo thelbi nga e cila është nxjerrur e keqja dhe pluhuri. Përderisa tenrul xhemë janë hurmat e mbetura nga të gjitha llojet e ndryshme (“Subules-selam”, 3/38).
67. “El-um”, 3/34, 4/41, 7/267-270.
68. “Usulul fikhi”, 281, Ebu Zehra.
69. “El-Furukë”, 2/32.
70. “El-mulkijeti ve nedharijetul aketi”, 215, prof. shejh Muhamed Ebu Zehra.
“El-Eshbahu ven-nedhairu”, 110, Ibni Nexhijm.
“Hashijetul Hamevij ala el-eshbahu ven-nedhair”, 2/13.
“El eshbahu ven-nedhair”, 40, Es-Sujutiju.
“Mugnil muhtaxh”, 2/37-38.
71. “Iëlamul mukiijn”, 3/117-119, 4/400.
72. “El-um”, 3/33, 7/70.
73. Ibid, 3/123.
74. Ibni Hanbel, 327, prof. Muhamed Ebu Zehra.
“Malik”, prof Muhamed Ebu Zehra.
75. “Iëlamul mukiijn”, 3/133.
76. “Iëlamul mukiijn”, 3/120.
77. Ibid.
78. “Ibn Hazmi”, 430, prof. Muhamed Ebu Zehra.
79. “El-Ihkam”, 6/748, botues El-Imam.
80. Ibid.
81. Ibid.
82. “El-ihkam fi usulil ahkam”.
83. E kanë regjistruar dy shejhët Ebu Davudi dhe Ahmedi nga Sead bin Ebi Vekasi, merfue në formën e tekstit: Mëkati më i madh i muslimanëve për muslimanët është kur ndokush pyet për diçka çka nuk është e ndaluar për njerëzit dhe ndalohet për shkak të asaj pyetje. (“Xhem’ul fevaidu”, 1/47).
84. Transmeton Ibn Maxhe, Tirmidhiu dhe Hakimi, e ka saktësuar dhe e ka harmonizuar edhe Dhehebiu.
85. “El-ihkam”, 1/747.
86. “El-Ihkam”, 6/746.
87. Transmeton Buhariu, Ebu Davudi dhe Nesaiju nga Aishja r.a. në formën e tekstit: O i dërguar i Allahut, një popull po na ofron ushqim dhe ne nuk e dimë a e kanë përmendur

emrin e Alalhut (kur e kanë prerë kafshën) apo jo? Është përgjigjur: Përmendeni ju dhe hane atë ushqim. (Aishja) Ka thënë: - Ai popull sapo e ka pas pranuar fenë islame. ("El-fevaid", 1/546).

88. Transmeton Ahmedi dhe Taberaniu në librin "el evsat" nga Ebi Hurejre. ("Xhem'ul fevaid", 1/779).

89. "El-ihkam", 6/749.

90. "El-lhkam", 6/755.

91. "El-ihkam", 6/745-757.

"Ibn Hazmi", 431, Ebu Zehra.

92. "El-muvafekatë", 4/201, Shatibiju.

93. "El-eshbahu ven-nedhairë", 1/41, Ibni Nexhimë.

94. Hanefijtë nuk e lejojnë marrjen me qira për afatgjatë, që qiradhënësi të mos thotë se është pronë e tij, që do të thotë më shumë se tri vite në pasuri të paluajtshme dhe një vit në çështje tjera. Njësoj edhe qiradhënia e pasurisë së jetimit. ("Tebjinil hakaik", 5/106, Ez-Zejleiju).

Kjo atëherë, kur qiradhënësi nuk e afatizon afatin e qiradhënies. Por nëse e kushtëzon që të përcaktohet afati, atëherë kushti pranohet qoftë afatshkurtë apo afatgjatë.

95. "I'elamul mukiijn".

"El muvafekat".

96. "Fetaa ibn Tejmijeti".

97. "Ibn Tejmijeti", 449, prof. Muhamed Ebu Zehra.

Argumentet tjera për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët

1. "Nejlul Evtarë".

"Irshadul fuhulë".

2. "El-mustesfa", 1/33, El-Esneviyu.

"El-muvafekatë", 3/298-304.

3. "El-mustesfa", 1/127.

"Irshadul fuhulë", 214, 215, Esh-shevkaniju.

"El-Esneviyu", 3/161.

4. Transmetim merfuë nga Ebi Hurejrete se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Për qenin i cili e ka vendosur gojën në enë, duhet të lahet tri herë ose pesë herë ose shtatë herë "vulugë", pirja e ujit me gjuhë ose vendosja e gjuhës në brendi të ujit dhe lëvizja e gjuhës në të.

5. Transmeton Muslimi nga Ebi Hurejrete në formën e tekstit: Pastrimi i ujit të ndonjërit prej jush nëse e ka përdorur qeni me gjuhën e tij është që të pastroj atë shtatë herë dhe njëra prej tyre të bëhet me dhe. ("Subules selam", 1/22).

6. "Err-Rrevdatu en-Nedijetu", 2/355.

7. "Nejlul evtarë", 8/58.

8. E ka regjistruar Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiju dhe e ka saktësuar Ibn Habbani dhe Hakimi. Tirmidhiu ka thënë: Është hadithë i mirë. ("Subules-selam", 4/66; "Nasburr-Rrajeti", 3/445).

9. "El-med-hal el fikhij", prof. Abdul Ali Atvetun.

10. “Nihajetus-sualë”, 3/175, botues “Sabijh”.
11. Transmeton Taberaniju në librin “Kebijr” nga thënia e Amr bin Asit: Ne u kemi dhënë premtimin që të fshehin ligjet e tyre në mes vete.
12. “El-Bedaiu”, 2/310-311.
“El-hidajetu”, 1/155-159.
13. “Tarijhu-n-nudhumu-l-kanunijeti vel-ixhtimaijети”, fq. 194, prof. dr. Sufi Ebi Talib.
“Fexhrul islami”, Ahmed Emijn.
“Tarihu-t-teshriul islami-s-sijasi”, Abdurrahman Taxh.
“Emval ven-nedharijetul akd fi fikhil islamij”, dr. Muhamed Jusuf Musa.
“El-fikhul islami”, (“el-med-hal ven-nedharijetul akd”, 117, prof. Ajseviji).

Përmbajtja:

<i>Masat ligjore</i>	4
Definicioni i mjeteve dhe masave ligjore	5
Niveli i obligimit prej mjeteve dhe masave ligjore	7
Dallimi në mes të “masës (mjetit) ligjore” dhe “bazës juridike”	9
Baza e dispozitës së gjykimit në masa ligjore	11
Si shikohen masat ligjore në aspekt të përgjithshëm?	13
Pengimi i dëmit të përgjithshëm me sferën e dispozitës për këtë botë me masat ligjore	16
Llojet e masave ligjore	18
Si i ndanë Ibn Kajimi masat varësisht prej llojit të rezultatit?	18
Si i ndan Shatibiu masat ligjore varësisht prej forcës së rezultatit?	19
Argumentimi i masave parandaluese dhe mendimet e dijetarëve	22
Analiza e boshtit të mospajttimeve të dijetarëve për masat ligjore	25
Argumentimi i ndalimit të shitblerjeve me kamatë	29
Gjeneza e mospajtimit në mes të dijetarëve	34
Triumfi i Ibni Kajimit me parimin e realizuesit apo “qëllimin e aktit”	36
Ibn Hazmi dhe masat parandaluese	38
Replikimi i mendimeve të Ibni Hazmit	40
Dakordimi i Ibni Hazmit dhe Shafiiut	44
Vërejtjet ndaj mendimit të Ibni Hazmit	45
Faktorët të cilët kanë ndikuar që Ibn Hazmi të mos i pranoj masat ligjore	47
<i>Lajkatimet ligjore</i>	48
(SHTOJÇË)	52
Argumentet tjera të fikhut për të cilat dijetarët nuk janë pajtuar	52

<i>Baza e çështjeve.....</i>	<i>53</i>
<i>Istikrai</i>	<i>54</i>
<i>Të vepruarit me minimumin.....</i>	<i>55</i>
<i>Burimet e fikhut të cilat nuk janë të sheriatit.....</i>	<i>58</i>
<i>Autorizimi.....</i>	<i>62</i>
<i>Ligji Zëvendësues.....</i>	<i>64</i>
<i>Ligji romak.....</i>	<i>66</i>

